

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7772 E enjte 24 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga KRISTALINA GEORGIEVA



Investimet e duhura për të trajtuar krizën e kapitalit njerëzor

Për 75 vjet, Banka Botërore ka qenë në krye të zhvillimit, duke ndihmuar vendet të bëjnë investime të zgjuara për t'i përgatitur qytetarët e tyre për ...
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga "DEUTSCHE WELLE"



Erdogani në Moskë: Plane të reja për Sirinë?

Presidenti turk, Erdogan, u takua dje me presidentin rus, Vladimir Putin në Moskë. Siria është tema qendrore e bisedimeve, edhe këtë herë. Të dy ...
Vijon në faqen 21



Meta: Firmë ka ministri i dekretuar

Rama "i jep" Cakajt Ministrinë e Jashtme, Bushati: E ardhmja, s'ka garanci për mirë

Flet zv/ministri i Jashtëm: Moshja e re u është dukur faj dhe jo burim energjie

Pas një debati që ka zgjatuar afro 1 muaj, kryeministri Edi Rama ka mundur më së fundi që drejtimin e diplomacisë shqiptare t'ia kalojë Genti Cakajt, por jo si ministër de juro, por de facto. Një ditë pasi bëri betimin në Presidencë, kryeministri Edi Rama, nëpërmjet një ceremonie të posaçme të organizuar në ambientet e Ministrisë së Jashtme ...
Në faqen 3

EMRAT/ AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONES SHPERNDAN 258 MILIONE LEKE

PRONARET, ATP: SI NDAHEN 2 MILIONE EURO KOMPENSIM

Pagesat e përshpejtuara, kush janë subjektet përfitues. Kompensimi i veçantë, aplikimet u bënë gjatë 3 viteve të fundit. Fondi për qytetin e Tiranës dhe rrethet



(Në foto) Ndërtime në Tiranë

LISTA E PLOTE

Vendimi i ri, 1340 vende të lira pune në administratë, ja si të aplikoni

Në faqet 10-11

ADMINISTRATORI

Skandali i tenderit të Unazës, gjykata jep burg në mungesë për Avdiol Dobin

Në faqen 7

KRIMI NE GREQI

Anxhelina u vra nga i ati, e ëma: Të afërmit e burrit s'më ndihmuan për trupin

Në faqen 6

PROPOZIMI

Pastrimi i parave, politikanët nën vëzhgim 10 vjet pasi lënë detyrën

Në faqen 4

TURIZMI



Aktorja e "Fast and Furious" në 'Prestige Resort': Ehtë i mrekullueshëm

Në faqen 13

Dosja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda: Suel Çela goditi makinat e policisë

"Të fortët" në Elbasan, akuzë për tentativë vrasjeje

Incidenti tek Tregu, 4 policë të dëmtuar. Emrat e të pandehurve

NGA KLODOIANA LALA

TIRANË. Prokuroria për Krime të Rënda ka përfunduar hetimet lidhur me sulmin e rëndë ndaj Policisë së Shtetit, ngjarje kjo e ndodhur në shtator të vitit 2017, në hyrje të tregut agrorshqimor në Elbasan. Marjuz Lulaj alias



Suel Çela, djali i pronarit të tregut agrorshqimor dhe dy miqtë e tij, Enea Bekteshi e Kelmend Xhaferri do të përgjigjen përpara drejtësisë, për akuzën e "Vrasjes së punonjëseve të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim...
Në faqen 7

ÇËSHTJA "CAKAJ" DEBATI

Rama i delegoi Cakajt detyrën e kryediplomatit, presidenti: Çështje e ekzekutivit

'Cakaj', Meta: Ministri i dekretuar, i vetmi që mund të firmosë

"Respektoj kompetencat e mia kushtetuese"

Valentina Madani

Për Presidentin e vendit, Ilir Meta, i vetmi që mund të firmosë për marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë është ministri i dekretuar prej tij, në rastin konkret Edi Rama si ministër i Punëve të Jashtme. Ndonëse nuk e dekretoi Gent Cakajn si ministër i Jashtëm, Presidenti Ilir Meta preferon të mos ndërhyjë e aq më pak të komentojë delegimin e kompetencave që kryeministri Edi Rama i bëri vartësit të tij për të qenë në krye të këtij dikasteri. Kreu i shtetit e quan kalimin e stafetës nga Bushati të Cakaj si çështje të brendshme të ekzekutivit, por nuk nguron të theksojë se i vetmi që mund të firmosë për marrëveshje ndërkombëtare është ministri i dekretuar prej tij. Sipas tij, është e drejtë e qeverisë organizimi i brendshëm dhe se presidenti nuk ndërhy, por zbaton Kushtetutën. "Presidenti nuk ndërhy dhe nuk komenton për aktet e organizimit të brendshëm të ekzekutivit apo të ministrive. Unë si President i Republikës respektoj Kushtetutën dhe i kam shumë të qarta kompetencat e mia se cilit institucion mund t'i delegoj autoritetin kushtetues për të lidhur marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë", deklaroi z.Meta. Edhe pse dekretoi Edi Ramën si ministër të Jashtëm, përplasja mes dy institucioneve, të Kryeministrit dhe Presidentit duket se do të vijojë edhe në Gjykatën Kushtetuese, sapo ajo të plotësohet. Kreu i qeverisë është i mendimit se me mosdekremin e Gent Cakajt në krye të Ministrisë së Jashtme, Presidenti ka shkelur Kushtetutën. Ndërkohë, mosmarrëveshja për emrin e ministrit të Jashtëm do të shkojë për shqyrtim në Gjykatë Kushtetuese, pasi kreu i qeverisë, Rama pretendon se Presidenti Meta ka shkelur Kushtetutën me mosdekremin e Gent Cakajt si ministër.



Presidenti Ilir Meta

KLAJDA GJOSHA

"Akti i kryeministrit me kalimin e përgjegjësisë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, është një akt që tregon edhe një herë përpëitjet e fundit të një diktatori të sëmurë për pushtet!", - tha ish-ministria e Integritimit.

Cakaj me kompetenca ministri, Nishani: Skandal

Berisha: Rama zgjodhi Cakajn se është për "copëtimin e trojeve shqiptare"

Ish-kryeministri Berisha reagoi dje ashpër, pasi kryeministri Edi Rama i delegoi zëvendësministrit Gent Cakaj kompetencat e drejtimit të Ministrisë së Jashtme. Berisha shprehet se Rama e ka shndërruar Ministrinë e Jashtme në një nevojtoare personale, ndërsa Cakajn e zgjodhi vetëm sepse është për "copëtimin e trojeve shqiptare". "Ai, në kundërshtim flagrant me Kushtetutën e vendit, ligjin organik të Këshillit të Ministrave i delegoi detyrën mender hales së tij në atë ministri, për meritën e vetme se është shprehur për copëtimin dhe tregtimin e trojeve shqiptare dhe që nuk guxon të afishojë veten se cili është. Ndaj atij, që Zografi bis i delegoi detyrën, deri sa Gjykata Kushtetuese të vendosë



ndryshe, rëndon refuzimi me dekret kushtetues të Presidentit të Republikës si i padenjë për postin e ministrit të Jashtëm. Por për të, ligji dhe Kushtetuta nuk ekzistojnë dhe sot (dje) ai provoi se ndjehet më komod si një jashtëqitje e Edi Ramës në atë detyrë se sa një njeri civil, i lirë që respekton Kushtetutën, ligjet e vendit". Edhe ish-pres-

“

DHURATA ÇUPI

"Shqiptarët nuk kanë pse çuditen kur shohin kryeministrin që ka frikë të mbajë përgjegjësi për veprimet e tij, duke ua deleguar ato vartësve, siç bëri me zëvendësin në Ministrinë e Jashtme. Kryeministri është rekordmen i frikës së veprimeve të tij", tha deputetja e PD.

identit Nishani e cilëson këtë si veprim skandaloz, poshtëruese dhe të turpshëm. "Sjellja poshtëruese dhe shkatërruese ndaj shtetit tonë ia kalojë më në fund edhe asaj të diktaturës që ishte më kriminale, më xhanavarja dhe më injorantja e shekullit modern evropian", shpreh z. Nishani.

kësaj bashkie, Xhelal Mziu. "Me rastin e 100-vjetorit të kalimit në përjetësi të patriotit të madh, burrit të ndritur dhe themeluesit të shtetit të ri shqiptar, Ismail

Qemali, u ndjeva sot jashtëzakonisht i lumtur të merrja pjesë në ceremoninë e vendosjes së emrit të tij në një prej rrugëve kryesore të Bashkisë Kamëz", - shkruan



Kryeministri Edi Rama, ish-ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe zëvendësministrit Gent Cakaj dje në MEPJ

Delegimi, Mediu: Veprim absurd, kalbëzim i qeverisë

Kreu republikan, Fatmir Mediu, e cilësoi dje si absurd vendimin e kryeministrit Rama për t'i deleguar kompetencat e ministrit të Jashtëm, zv.ministrit Gent Cakaj. Mediu shkruan se ulja e nivelit të përfaqësimit është shkatërruese për politikën e jashtme dhe e paprecedentë. "Veprimi i Ramës për të deleguar një autoritet kushtetues si ministri i Jashtëm të një zv.ministrit Gent Cakaj, është një veprim absurd, i cili tregon kalbëzimin e qeverisë shqiptare. Ne jemi përballë sfidash kombëtare, siç është hapja e negociatave me BE. Diskutimi i kufijve detarë me Greqinë. Dialogu Kosovë-Serbi. Përgjegjësia e madhe me marrjen e Presidencës së OSBE. Ulja e nivelit të përfaqësimit në këto çështje është shkatërruese për politikën e jashtme, e paprecedente dhe idiotike", tha z.Mediu.

Cakaj ministër i deleguar, Shehu: Akt i paprecedent

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu, reagoi dje pas delegimit të kompetencave nga Edi Rama për ministrin e ri të Jashtëm, Gent Cakaj. Shehu shkruan në 'FB' se ky është akt i paprecedentë antikushtetues. "Kryeministri me 'delegimin' e kompetencave të ministrit të Jashtëm, kandidatit të rrezuar kryen një akt të paprecedentë antikushtetues. Kompetencat ministeriale, veçanërisht ato të ministrit të Jashtëm nuk mund t'i delegohen askujt, ashtu si dhe përgjegjësitë e atij posti shumë të rëndësishëm e delikat. Këtu kemi të bëjmë me një veprim jo thjesht arrogant, por që dëmtton rëndë edhe interesat tonë shtetërore e ato kombëtare", tha deputeti demokrat.



forçimit të identitetit kombëtar dhe themelimit të shtetit modern, meriton të gjithë nderimin e respektin tonë të pakufishëm, si komb, shoqëri dhe institucione".



Bushati thumbon Ramën: Ajo që vjen s'është më e mirë se ajo që lamë pas

Në fjalën e tij të fundit si ministër i Jashtëm, Ditmir Bushati, ndonëse është treguar i qetë, nuk e ka fshehur pakënaqësinë ndaj vendimit për t'u larguar nga detyra e kryediplomatit të Shqipërisë. Megjithatë në mënyrë diplomatike, ai ka thumbuar kryeministrin Edi Rama për këtë vendim, duke bërë të qartë se askush nuk mund të jetë i sigurt se ajo që vjen është më e mirë se ajo që lëmë pas. "Nuk ka garanci se ajo çfarë kemi përpara, do të jetë më e mirë a më e lehtë se ajo çfarë po lëmë pas", - tha Bushati. Por, pavarësisht kësaj, ai theksoi se të qenurit për një kohë të gjatë në këtë detyrë, pavarësisht kundërshtarëve që mund të ketë krijuar e ka



Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati

bërë atë më të fortë. "Puna jonë transformuese ka krijuar me siguri të pakënaqur dhe kundërshtarë. Por një gjë është e sigurt: sfidat na kanë bërë më të fortë, më të qëndrueshëm e shpresoj më të denjë për Shqipërinë e të

nesërme", - u shpreh ish-ministri i Jashtëm. Natyrisht që në këtë fjalë të fundit, ai shprehu edhe një ndjesë për familjen e tij, e cila ka ndjerë më shumë angazhimin e tij në krye të diplomacisë. "Për një falënder-

im të fundit do të më ndihmonte një rrëfim personal i ish-kolegut tim të çmuar dhe Presidentit aktual të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, sipas të cilit ministri i Jashtëm është i munguari i madh: i mungon ekipit të ministrisë në përditshmërinë e tij, i mungon përditshmërisë politike dhe i mungon familjes së tij. Është pikërisht familja, e cila ka vuajtur më shumë e ka falur më lehtë çdo mungesë timen, duke mbështetur rrugëtimin tim. Dëshiroj t'i falënderoj për përkushtimin e tyre gjatë mungesave të mia e t'u kërkoj një falje për fundjavat e humbura në 'Blackberry' dhe 'Iphone'", - nënvizoi ish-ministri Ditmir Bushati në fjalën e tij.

Kreu i qeverisë i ka deleguar Cakajt kompetencat për të drejtuar ministrinë

Rama sfidon kritikët, bën de facto Genti Cakajn ministër të Jashtëm

Cakaj: Moshja e re u është dukur faj dhe jo burim energjie

Pas një debati që ka zgjatur afro 1 muaj, kryeministri Edi Rama ka mundur më së fundi që drejtimin e diplomacisë shqiptare t'ia kalojë Genti Cakajt, por jo si ministër de juro, por de facto. Një ditë pasi bëri betimin në Presidencë, kryeministri Edi Rama, nëpërmjet një ceremonie të posaçme të organizuar në ambientet e Ministrisë së Jashtme, morri zyrtarisht dje edhe detyrën e ministrit të Jashtëm, por vetëm për pak momente. Kjo, pasi vetë kryeministri Edi Rama i delegoi detyrën 28-vjeçarit nga Kosova përmes një fjalimi, që siç bëri të ditur ai, ishte më i shkurtër që kish të mbajtur ndonjëherë. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe ministri Ditmir Bushati që la detyrën, si dhe stafi i MEPJ, trupi diplomatik shqiptar jashtë dhe ai i akredituar në Tiranë.

RAMA
Në fjalën e tij, kreu i qeverisë do të lexonte vetëm aktin e delegimit të kompetencave, ndërsa ia dorëzoi atë në mënyrë publike dhe demonstrative zëvendësministrit Genti Cakaj, që do të luajë tashmë edhe rolin ministrit të Jashtëm. "Unë, i nënshkruari Edi Rama, në funksionin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, i delegoj Zotit Genti Cakaj, zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme, detyrën e drejtimi të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësimit të ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, brenda dhe jashtë vendit", - u shpreh kryeministri Rama, teksa i kaloi Cakajt drejtimin e punëve të MEPJ.



CAKAJ
Menjëherë pas Ramës, fjalën e ka marrë ministri i ri de facto, Genti Cakaj. Me një buzëqeshje që shoqëroi gjithë fjalimin e tij të parë në këtë detyrë të re, ai falënderoi Bushatin për kontributin e dhënë si dhe kryeministrin Rama për besimin e shprehur për ta emëruar në një detyrë kaq të rëndësishme. "Ky transferim autoriteti institucional nga zoti Bushati, të cilin e falënderoj nga zemra për

kontributin e tij në këtë ministri tek unë përmes kryeministrit Rama, që nuk di as si ta falënderoj për kujdesin e dhënë dhe besimin e treguar ndaj meje në çdo hap, nuk nënkupton asnjë ndryshim objektivash strategjike dhe politike të qeverisë shqiptare në kuadër të politikës së saj të jashtme", - u shpreh Cakaj. Më tej ai u shpreh se me energji të reja dhe qasje proaktive do të vazhdojë pa asnjë diskutim të shtytë përpara

“ PËR RAMËN
"Uroj që kushdo që ka thënë fjalë të mira për mua këto ditë dhe nuk e ka humbur besimin, kryeministri në veçanti, të mos jetë i zhgënjyer nga paraqitja ime e parë dhe unë ju premtoj se do të jeni gjithnjë e më i kënaqur në punën time në vijim".

“ PËR KRITIKAT
"Koha, thotë Podrima, shpeshherë ecën mbi shpinën e breshkës. Dhe po gjatë këtyre ditëve koha ka ecur ngadalë, por koha shpeshherë është më kokëfortë sesa e ngadalë. Mbetem me shpresë se punët që do të bëj do të flasin përmbajtësisht për mua".

Paskal Milo: Rama dhe Meta të konsultohen paraprakisht për emërimet

Për ish-ministrin e Jashtëm, Paskal Milon, akti i delegimit të kompetencave nga Edi Rama të zëvendësi i tij Genti Caka është kushtetues dhe i ligjshëm. Duke komentuar zhvillimet e fundit në Ministrinë e Jashtme, ai theksoi se presidenti dhe kryeministri duhet të kenë më shumë kujdes kur bëhet fjalë për diplomacinë, ndërsa shprehet se mosmarrëveshje të tilla duhet të zgjidhen me konsultime paraprake mes palëve. "Në këtë rast ne jemi dëshmitarë të një përplasjeje tjetër institucionale. Por prej këtyre përplasjeve duhen nxjerrë mësimet, siç janë konsultimet paraprake para marrjes së vendimeve të rëndësishme", - tha Milo për "Ora News". Nga ana tjetër, ai shprehet se nuk ka asnjë frikë sa i përket devijimit të politikës së jashtme, pasi për Milon ajo nuk bëhet vetëm nga një person, por nga tërësia e institucioneve kryesore në vend. "Kryeministri ka qenë dhe do të jetë shumë i angazhuar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Tërësia e institucioneve shqiptare që përcaktojnë qëndrimet e shtetit shqiptar në politikën e jashtme dëshmojnë se Shqipëria nuk ka lëvizur nga pozicionet e saj", - u shpreh Milo.

men e Shqipërisë në BE, Cakaj lajmëroi muaj të vërtetë dhe intensivë për punonjësit e kësaj ministrie. Në fund, ai foli edhe për kontestimet që pati emri i tij nga Presidenti i Republikës dhe një pjesë e mirë e opinionit publik, duke theksuar se ishte parasykruar për shkak të moshës. "Pas kalimit të valës së parë zjarrit të pakursyer për mua, ndjehem disi më i lehtësuar, kjo mbi të gjitha për një shkak tepër të fortë,

MOSHA
"Pas kalimit të valës së parë zjarrit të pakursyer për mua, ndjehem disi më i lehtësuar. Të qenit drejtues me kompetenca të deleguara nën vëzhgimin e tij të afërt është një start i garantuar në dritën e zjarrit të akuzave të papabazave dhe paragjyqimeve. Delegimi i kompetencave tek një zv.ministër si unë dhe mosha e re u është dukur faj dhe jo burim energjie dhe kreativiteti disa njerëzve".

MAXHORANCA INICIATIVA

Bankat duhet të kontrollojnë politikanët për një kohë të gjatë pasi lënë detyrën

Pastrimi i parave, politikanët të vëzhguar deri në 10 vjet pas detyrës

Çdo shumë mbi 10 mijë euro duhet të deklarohet në kufi

Të gjithë politikanët dhe drejtuesit e institucioneve të rëndësishme në vend do të jenë në "lupën" e Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, bankave dhe doganave edhe 10 vite pasi të largohen apo të lënë detyrën përkatëse. Këtë e parashikon projektligji i hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe që është konsultuar informalisht me bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e transferave, Shoqatën e Bankave, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Nisma në fjalë vjen në kuadër të rekomandimeve që bën raporti i Moneyval për Shqipërinë, lidhur me masat ndaj parandalimit të pastrimit të parave, ndërsa tenton të forcojë edhe më tej masat kundër subjekteve që mund të kërkojnë të përdorin mekanizma të ndryshëm për pastrimin e parave të vëna apo të krijuar në mënyrë të paligjshme nëpërmjet veprimtarive kriminale apo edhe korrupsionit gjatë ushtrimit të një detyre shtetërore. Me ligjin aktual "Personat e ekspozuar politikisht" janë personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarinë e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislativës për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike". Sipas projektligjit të paraqitur përcaktohet se "kjo kategori individësh konsiderohen "persona të ekspozuar politikisht" deri në 10 vite pas largimit nga funksioni. Madje projektligji parashikon që sipas gjykimit të vetë subjektit, ky afat mund të shtrihet edhe përtej 10 vjetësh. Nëpërmjet këtij projektligji ndryshon edhe procedura e kontrollit dhe nivellet e shumave që janë të detyrueshme për t'u deklaruar në kufi. Kështu sipas projektligjit "Çdo person, i cili hyn/largohet në nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera,



Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave, Arlind Gjokutaj dhe ish-kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj

qëllimin e mbartjes së tyre si dhe dokumente justifikuese përkatëse. Kanë detyrim për deklarinë edhe përfaqësuesit e personave që hynë/largohen me mjete sipas pikës 1, kur këto transportohen nëpërmjet shërbimit të kontejnerëve apo postar", - thuhet në projektligj. Për të gjithë ata që shkelin këto dispozita nisma ligjore ka parashikuar edhe penalitete me gjoba që shkojnë deri në 40 për qind të shumës së padeklaruar. Persona që do jenë nën vëzhgimin e rreptë të institucioneve bankare, doganore dhe vetë Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave do jenë edhe ata që kanë bërë një policë sigurimi jete.

GJOBAT PËR ATA QË BËJNË DEKLARIM TË RREMË

- a) Për shumat nga 10,000-19.999 euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera, gjoba është në vlerën 5% për herën e parë, 10% për herën e dytë si dhe 30% për rastet e tjera;
- b) Për shumat nga 20,000-49.999 euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera, gjoba është në vlerën 10% për herën e parë, 20% për herën e dytë si dhe 40% për rastet e tjera;
- c) Për shumat mbi 50.000 euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera, gjoba është në vlerën 15% për herën e parë, 30% për herën e dytë si dhe 50% për rastet e tjera" thuhet në projektligj.

DEKLARIMI

"Çdo person, i cili hyn/largohet në nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera



Një nga protestat e e fundit të opozitës

MONEDHAT VIRTUALE BITCOIN OBJEKT HETIMI DHE KONTROLLI

Pjesë e vëzhgimit të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave do jenë edhe mjetet virtuale financiare. Kështu në ligj përfshihen për herë të parë mjetet virtuale të tregtuara në formë dixhitale siç mund të jetë bitcoin, por jo vetëm. "Mjet virtual është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet digjitale të monedhve të njohura zyrtarisht, letrave me vlerë dhe mjeteve të tjera financiare që janë parashikuar nga legjislativën në fuqi".

Mazhoranca kundër Bahri Shaqirit për kryetar KLSH-je

Ndonëse nuk kanë ende një qëndrim përfundimtar lidhur me kandidaturën e Bahri Shaqirit për kryetar KLSH-je, mazhoanca duket se është e vendosur që të mos e votojë edhe këtë propozim të dytë të presidentit Ilir Meta. I pyetur për votën që do të kenë social-taulant Balla u shpreh se si kryetar i grupit parlamentar, do të flasë i fundit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat parlamentare, por duke lënë të kuptohet se ai duhet të plotësojë kriteret

ligjore. "Sapo Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Administratës Publike në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni i Ekonomisë, të kenë kryer secënën dëgjimore dhe verifikimin e përmbushjes së kriterëve që përcakton ligji, do

t'ju komunikojmë qasjen dhe vendimin tonë. Ne duam që në institucione kaq të rëndësishme të auditimit financiar të jenë persona që kanë eksperiencë të gjatë, që kanë njohuri dhe shumë përkushtim në kryerjen e kësaj detyre.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Apt 1, Tiranë, ngjorton se më datë 22.02.2019 ora 8^h - 16^h në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III-të për shpalljen e pasurisë së paluashtme. Anë, me sipërfaqe 13.000 m². Nr. pasurie 38/10, Zona Kadasstrale Nr. 1669, Vol. 5, Fq. 202, në pronësi të: Z. Behar Ibrahim, Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduart Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillëstare në ankannd 98.280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluashtme, Anë, me sipërfaqe 8.200 m². Nr. pasurie 6/4, Zona Kadasstrale Nr. 1669, Vol. 4, Fq. 34, në pronësi të: Z. Fatmir Kazi, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillëstare në ankannd 115.320 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë) EURO. Të interesoarritë kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

Nisma, nga bizneset te OJF, ja kush duhet të hapë llogari bankare

Në kuadër të forcimit të masave të lëna si detyrë nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, Shqipëria ka ndër marrë një sërë ndryshimesh ligjore për forcimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave të pista. Për këtë qëllim në zbatim të këtyre detyrave Ministria e Financave ka hartuar dy projektligje të veçanta që kërkojnë të formalizojnë lëvizjen e parave nëpërmjet bankave dhe reduktimin në maksimum të parave që qarkullojnë në formë fizike në dorë. Për këtë qëllim propozohet të sanksionohet në ligjin për procedurat tatimore, detyrimi i të gjithë tatimpaguesëve persona fizik/juridikë, përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse për të pasur llogari bankare biznesi. Ndërkohë parashikohet që mos të jenë subjekte të këtij detyrimi, tatimpaguesit, persona fizikë tregtar të cilët realizojnë qarkullim vjetor, rrjedhimisht edhe qarkullim të parasë fizike, në vlera të ulta. Për këtë arsye, është marrë për referencë, kufiri i regjistrimit për përgjegjësinë tatimore: tatimi mbi vlerën e shtuar. Sjellim në vëmendjen se, sipas ligjit 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", nuk janë subjekt i detyrimit për t'u regjistruar për TVSH-në, tatimpaguesit, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor, më të vogël se 2 milion lekë. Gjithashtu, parashikohet vendosja e një afati të përcaktuar për përmbushjen e këtij detyrimi si dhe dënimi në rast të mospërmbushjes së tij nga ana e tatimpaguesit. Neni 2, përcakton dënimet administrative në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi. Më konkretisht personi fizik tregtar, me qarkullim deri në 8 milionë lekë, gjobiten në masën 50 000 lekë, personi juridik parvarësisht nga qarkullimi, si dhe personi fizik tregtar me qarkullim mbi 8 milionë lekë, gjobiten të masën 100 000 lekë. Ndërsa organizatat jofitimprurëse, gjobiten në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.



Deputetët dhe anëtarët e kryesisë takime konsultative me strukturat deri të shtunën

Vendimi, PD delegon deputetët në rrethe për protestën e 16 shkurtit

Paloka: Shqiptarë, ejani të rrëzojmë Ramën

Valentina Madani

Deputetët dhe antarët e kryesisë së re të PD-së do të zbrisin në terren për organizimin e protestës së paralajmëruar më 16 shkurt. Çdo deputet në zonën e tij elektorale i shoqëruar edhe nga një anëtarë i kryesisë së PD-së do të nis takimet konsultative me strukturat e partisë për problematikat që kanë duke i përcjellë ato në qendër ndërkohë që në bazë të tyre do të bëhet dhe kalendari i zhvillimit të protestave në rrethe. Ky proces duhet të mbyllet deri të shtunën ditë të cilën do të përcaktohet dhe grafiku i protestave. Në mungesë të kreut të PD-së, Lulzim Basha, në nënkryetari demokrat Edmond Spaho mbledhi dje grupin parlamentar për organizimin e protestës së paralajmëruar më 16 shkurt. Në Tiranë janë përcaktuar Aldo Bumçi, Gazment Bardhi, Albana Vokshi, Jorida Tabaku, Grida Duma, në Fier është caktuar Enkelejd Aliibeaj, ndërsa Flamur Noka është vendosur për qarkun e Shkodrës. Opozita ka vendosur që protesta e parë do të zhvillohet më 16 shkurt në kryeqytet. Kësaj proteste do i paraprijnë protesta të vogla edhe në rrethe. Nënkyetari i PD-së, Edi Paloka ftoi qytetarët që t'i bashkohen protestës së opozitës. Protesta e opozitës është paralajmëruar për më 16 shkurt. Paloka pas përfundimit të mbledhjes së grupit, deklaroi se diskutimi është fokusuar tek organizimi i protestave, veçanërisht tubimit të madh të 16 shkurtit. Në deklaratën e tij për mediat Paloka theksoi se protesta është e vetmja rrugë për rrëzimin e qeverisë 'Rama'. "Grupi i PD diskutoi për protestat dhe përgatitjet dhe nevoja për të protestuar kundër një kryeministri që kupton vetëm këtë rrugë. Nëse qytetarët nuk reagojnë e nuk i bashkohen thirrjes së opozitës, çdo gjë do të shkojë keq e me keq. Por rriten taksat, varfëria emigracioni etj. Qëllimi që ne po thërresim qytetarët është të vijmë të gjithë ata që kanë një hall, ata që u prishen shpëtimet, që kanë fëmijët në shkollë, biznesi për taksat etj, pra kushdo që ka një hall, duhet të ngrihet e të protestojë kundër Edi Ramës, ndryshe ai do bëjë arrigantin e do shkelë me këmbë shqiptarët", informoi z.Paloka. Nënkyetari

tari i PD-së replikoi edhe me ambasadorin e BE-së Luixhi Soreka, i cili deklaroi se vendi i opozitës është në parlament dhe institucione. "Ambasadori i BE-së, dy javë më parë deklaroi hapur se lufta ndaj kimit në Shqipëria ka mbaruar. Madhe edhe ajo luftë që kishte filluar në

thonjëza me të famshmen 'Forca e Ligjit', një ministër paraardhës i Ramës, edhe ajo luftë është ndërprerë. Edhe për këtë pjesë shqiptarët duhet të ngrihen që të mos bëhen viktima të krimit kudo që dalim. Dhe më mirë se sa shqiptarët që kërkojnë të integrohen në Europë, më mirë

se sa ne që jemi viktima të këtij regjimi, nuk mund ta kuptojë asnjë tjetër. Ne presim, meqë përmendët integrimin, ose më mirë prisnim, që në qershor të hapeshin negociatat. Ambasadori e tha edhe këtë. Me këtë formë dhe me këtë regjim ju jemi, ashtu si po shkojmë përditë me Edi Ramën kryeministër, as negociata s'do ketë dhe gjërat do shkojë keq e me keq. Për këtë arsye i kemi thirrur qytetarët t'i bashkohen opozitës dhe të protestojmë të gjithë bashkë për hallet dhe problemet që kanë", -tha z.Paloka. Partia Demokratike dhe aleatët kanë vendosur të protestojnë në 16 shkurt ora 11:00 në Tiranë, përpara Kryeministrisë për largimin e qeverisë. Protesta e fundit e organizuar nga opozita ka qenë ajo e 26 majit 2018 përpara Kryeministrisë. Opozita kërkoi largimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, pas audio-përgjimit të Babales dhe të denoncuar nga PD ku pretendohet se ishte regjistruar Agron Xhafaj, teksta fliste për trafikimin drejt Italisë të një sasive kanabisi.



Kryesia e re e PD-së

VENDIMI

Çdo deputet në zonën e tij elektorale i shoqëruar edhe nga një anëtarë i kryesisë së PD-së do të nis takimet konsultative me strukturat e partisë për problematikat që kanë duke i përcjellë ato në qendër ndërkohë që në bazë të tyre do të bëhet dhe kalendari i zhvillimit të protestave në rrethe.



"Të përmbysim sa më shpejt regjimin e Ramës"

Protesta, Kryemadhi: Të bashkuar mund t'i bëjmë ballë sundimit të Ramës

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi zhvilloi dje një takim me strukturat e kësaj force politike në Kamzë. Ajo u bëri thirrje shqiptarëve që t'i bashkohen protestës së opozitës e planifikuar të mbahet në datën 16 shkurt në Tiranë dhe rrethe. Kryemadhi bëri përgjegjës Edi Ramën për rrënimin e jetës së qytetarëve shqiptarë ndaj ajo i ftoi të bashkohen në protestë për ta rrëzuar "një orë e më parë". "Bashkia e Kamzës, është një bashki që qeveria e shikon si periferi, 99% e banorëve të Kamzës kanë ardhur kryesisht nga veriu, si Kukësi dhe Dibra nga jam unë, por të gjithë janë njerëz punëtorë. Dhe, në fakt, gjithmonë janë parë si njerëz që janë kalimtarë, nuk i kanë parë asnjëherë me syrin që janë qytetarë. Ndoshta qytetarët e Kamzës mund të mos kenë diploma të mëdha apo doktoratura si puna ime, por kanë një zemër të madhe dhe mendje të ndritur. Ndaj le të fillojë organizimi i LSI për protestën e 16 shkurtit nga kjo bashki, që ka pasur në zemër të saj revoltën ndaj çdo padrejtësie. Të përmbysim këtë regjim që grabit çdo ditë e më shumë të rrëzojmë këtë sistem që dhuron të varfrit për të pasuruar të pasurit", tha zj.Kryemadhi. Ajo shtoi më tej: "Të ngrihemi të gjithë kundër këtij sistemi të kalbur. Ky sistem ka vetëm një emër, dhe emri është i Edi Ramës që ka marrë peng PS-në, qeverinë, parlamentin shqiptar. Vetëm të bashkuar ne mund t'i bëjmë ballë këtij".

"Opozita në protestë, s'luftojmë për pushtet"

Spaho: Nuk bojkotojmë zgjedhjet, PD po evidenton kandidatët fitues

Për në nënkryetarin e PD-së Edmond Spaho protestat kundër qeverisë "Rama" nuk kanë për qëllim pushtetin e opozitës, por për t'i hap rrugë zhvillimit dhe integritetit të vendit. Spaho u bëri thirrje qytetarëve, gazetarëve dhe intelektualëve që të mbështesin protestat e opozitës. Sipas tij Ramën kryeministër nuk ka integrim e as ekonomi të mirë. "Kjo nuk është një përpjekje për të sjellë opozitën në pushtet, por është një përpjekje e madhe për t'i siguruar vendit zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe pastaj cilado forcë politike që të fitojë le të qeverisë", deklaroi z.Spaho për "Ora News". Ai akuzoi se kjo qeveri ka asgjësuar çdo liri, ndaj sipas tij me kryeministrin Edi Rama nuk mund të shkohej në zgjedhje. "Të shpresosh që me Edi Ramën në



qeveri do të ketë zgjedhje në qershor normale si në çdo vend demokratik është iluzion dhe gabim i rëndë nga ana e opozitës, sepse do të përdoret si fasadë", -tha Spaho. Nënkyetari i PD-së hedh poshtë zërat se opozita po përgatitet për të bojkotuar zgjedhjet vendore. "Asnjë forcë demokratike nuk vjen

ZGJEDHJET

"Asnjë forcë demokratike nuk vjen në pushtet pa zgjedhje. Të gjitha përpjekjet që ne bëjmë tani, edhe protestat janë që të garantojmë kushte të garantuara që të konkurrojmë për zgjedhjet vendore", -tha z.Spaho.

në pushtet pa zgjedhje. Të gjitha përpjekjet që ne bëjmë tani, edhe protestat janë që të garantojmë kushte të garantuara që të konkurrojmë për zgjedhjet vendore", -u shpreh z.Spaho.

Xhezmië Hoxhallari në "News 24": Bashkëshorti i saj afgan përfundoi në spital

Anxhelina u vra dhe u gropos nga i ati, nëna shpërthen në lot: Ma morën vajzën

"Si e mora lajmin e kobshëm, të afërmit e ish-burrit s'më ndihmuan për të marrë trupin e vajzës nga Greqia"

TIRANË

Nëna e 28-vjeçares Anxhelina Petro, që u vra dhe më pas u gropos në oborrin e shtëpisë nga i ati, dje u bë pjesë e emisioni "Me zemër të hapur" në "News 24". Xhezmië Hoxhallari ka rrëfyer me detaje jetën e saj dhe marrëdhënien me vajzën, e cila u masakrua në Korfuz të Greqisë. Ajo tregoi se deri 16 vjeç, Anxhelina ka jetuar me të dhe më pas i ka kërkuar të shkojë me të atin, por që nga ai moment, vajzën nuk e kanë lënë ta takojë më nënën e saj. "Kur e mora vesh lajmin, erdhi një shoqja ime me burrin që më morën me makinë. Nuk më shkonte në mendje kurrë. Nuk e imagjinoja. Pastaj më tha shoqja që do bëhesh e fortë se Anxhelina ka bërë aksident me makinë dhe është në gjendje të rëndë. Kur shkuam brenda në shtëpi, më tha që Anxhelina është vrarë dhe më pas kam ulëritur 'çfarë po bëhet'", tha nëna për mënyrën se si e mori lajmin. E pyetur se kur e kishte folur për herë të fundit, nëna tha se ishte në tetor të vitit që shkoi. "Në tetor shtrua vajzën e vogël në Tiranë, pasi ishte sëmurë. Aty mori Anxhelina në telefon me kamera dhe folëm si gjithmonë. Pastaj fliste çupa gjithmonë me të shkruar. Po i flisja që të keqen mami je 28 vjeçe e tani duhet të krijosh familjen tënde. Mirë mami më thoshte, por nuk më hapte asgjë", pohoi Xhezmië Hoxhallari.

NËNA E VIKTIMËS

Ndërkaq, ajo tha se ishte ndarë me babain e Anxhelinës pasi ishte shumë xheloz. "Jam martuar në vitin '89 dhe linda vajzën në vitin 1990. Jo se ishte shumë i dhunshëm, por ishte xheloz shumë dhe i vit e gjysmë kam ndenjur me të. Ika vetë. Nuk kuptoheshim. Vajza donte të ikte vetë me të atin. Ajo vajti për të jetuar me të, por jo që të ndahej përfundimisht me ne. Nuk më linin që të kisha marrëdhënie me vajzën. Doja të veproja përmes shtetit, por kisha frikë se i bëja keq vajzës. Ata ma morën dhe e bllokuan vajzën. Ata thoshin se nuk do vajza të takojë ty", deklaroi Hoxhallari. Lidhur me marrëdhëniet me njerëzit e ish-burrit, ajo tha se nuk e kanë ndihmuar për të marrë trupin e vajzës nga Greqia. "Ish-kunata dhe vëllai i atij erdhën në shtëpi të tronditur e më thanë 'çfarë na ka ndodhur, kush e ka vrarë'. Unë iu thashë që dua ta marr këtu, nuk dua ta lë vajzën atje. E motra tha që nëse do ta marrësh, merre ti, ne nuk kontribuojmë", u shpreh nëna e 28-vjeçares. Ndërsa, sqaroi se ditën tjetër pasi mori lajmin, u nis menjëherë në Greqi për të marrë trupin e Anxhelinës. "Nuk po më mbante vendi për vajzën. Kam djalin e vëllait në Rodos dhe mbesat jashtë, më thanë nis. Me ndihmën e tyre e



Xhezmië Hoxhallari, nëna e 28-vjeçares, në emisionin "Me zemër të hapur" në "News 24"



Viktima Anxhelina Petro

MOTRA E VIKTIMËS

Motra e Anxhelinës, Klea ishte një nga personat që komunikonte më shumë me të. Ajo ka qenë e para që ka ngritur dyshime se Anxhelina mund të jetë përdhunuar nga i ati. "Nuk e di të sigurt, por kam dëgjuar shumë njerëz që flisnin për këtë gjë", tha ajo. Ndërsa pritet përgjigja e rezultateve të ADN-së për të vërtetuar nëse Angelina Petro është dhunuar seksualisht nga babai i saj, avokati i Aleko Petros, Vassilis Noullezas deklaroi se nëse rezultatet e analizave mjeko-ligjore e vërtetojnë, ai do të hiqte dorë nga çështja.

BABAI VRASËS

Pas vrasjes së 28-vjeçares, 52-vjeçari Aleko Petro është shprehur para policisë: "Më ndihmoni që të gjej vajzën time". Por pas marrjes në pyetje nga grupi hetimor, ka dhënë përgjigje kontradiktore duke bërë që të merret i pandehur si i dyshuari kryesor dhe pas disa orësh ka pranuar gjithçka "po, unë e vrava vajzën" duke treguar edhe vendin ku e varrosi. Mjeku-ligjor tha se Anxhelina kishte pësuar trauma në kokë nga goditjet e njëpasnjëshme dhe se vrasja e saj ishte brutale.

Xhaxhai i Anxhelina Petros: Nuk e ndalonim vajzën ta takonte, por ajo s'e donte nënën

TIRANË - Vëllai i Aleko Petros ose Bardhyl Gurit, që vrau në ditët e para të janarit vajzën e tij 28-vjeçare, Anxhelinën, ka reaguar me anë të një lidhje telefonike në emisionin "Me zemër të hapur" në "News 24". Ai ka mohuar se familja e të atit e ndalonte Anxhelinën të takonte nënën për vite me radhë, ndërsa tha se krimi është i dënueshëm. Nga ana tjetër, Gazi Gurit, deklaroi se vëllai i tij ka qenë një njeri i pastër dhe i ndershëm dhe se i ka dhënë gjithçka Anxhelinës. "Në lidhje me ngjarjen, im vëlla ka qenë



një njeri i pastër dhe i ndershëm. Edhe ne jemi tronditur shumë. Çupën nuk e kemi ndaluar ne. Çupa nuk e donte të emën. Ky është një

krim makabër: Nuk e dimë pse e bëri. Çupa ka një vit që është ndarë nga im vëllai", tha xhaxhai i Anxhelinës. I pyetur nëse ata ishin në dijeni që mbesa ishte e lidhur me një shtetas afgan, ai tha se nuk e dinin, pasi as vëllai dhe as mbesa nuk iu kishin thënë gjë. "Nuk dija gjë. Ne kemi folur gjithmonë, nuk na ka thënë. Në datën 1 janar kemi folur me vëllain si gjithmonë. Na tha jam mirë, do bëj bakllava. Nuk e ka dashur nëna sa e duam ne. Çdo njeri nuk e pranon një gjë të tillë që ka ndodhur", tha xhaxhai i viktimës.

saj dhe bashkëshorti afgan. Ajo rrëfyeu se kur ka shkuar në Korfuz, ka dashur të takojë burrin afgan të Anxhelinës, por ai ndodhet në spital në gjendje të rëndë për shkak të shokut. "Nuk e mendoja kurrë që e kishte vrarë babai (qan). Në Greqi

më pritën shumë mirë, i falënderoj dhe i respektoj për atë që kanë bërë. Dhe ajo nënoja që e ka pagëzuar, që është bërë nënë e dytë dhe bashkëshortin e vajzës, nuk e takova dot sepse ai kishte kaluar një gjendje shumë të keqe dhe ishte në spital. Edhe nënoja e kishte përjetuar shumë keq", tha nëna. Ngjarja e rëndë ndodhi në Alepou, Korfuz në ditët e para të Vitit të Ri. Babai shqiptar Bardhyl Gurit, i njohur në Greqi si Aleko Petro vrau vajzën Anxhelinën 28-vjeçare dhe më pas e varrosi në oborrin pas shtëpisë për të fshehur gjurmët, pasi ishte kundër lidhjes së saj me një të ri nga Afganistani. Ka qenë i dashuri i saj nga Afganistani që ka bërë denoncimin, pasi nuk po arrinte që të kontaktonte me 28-vjeçaren, e cila nuk ishte paraqitur në punë. Ai ishte i pari që ngriti dyshimet se vajza mund të ishte vrarë, pasi i ati nuk pranonte lidhjen midis të rinjve. Qeni besnik i vajzës shqiptare drejtoi hetuesit në vendin ku Aleko Petro kishte varrosur të bijën. Edhe sot, Roki qëndron jashtë derës së banesës duke pritur që Anxhelina të kthehet. Me pas policia ka marrë në pyetje të atin e vajzës, ku ka zbuluar se ishte ai autori i vrasjes.

SHKURT

Shpërthimi me tritol, shënjestër makina e mjekut kirurg

TIRANË - Zbardhen detaje të reja në lidhje me shpërthimin me tritol të ndodhur mëbrëmjen e së martës në rrugën "Belul Hatibi" në Tiranë, ku shënjestër ishte një makinë. Mësohet se mjeti me targa AA44100 është në pronësi të mjekut Dervish Hasi, kardiokirurg në një spital privat në Tiranë. Sipas bluve, nga shpërthimi u dëmtua pjesa e pasme e mjetit, të cilën mjeku e kishte parkuar në lagjen e tij. Nga të dhënat e para të grupit hetimor, thuhet se sasia e eksplozivit ishte shumë e vogël, ndërkohë që ka dyshime se autorët kanë dashur që të paralajmërojnë mjekun. Po ashtu thuhet se lënda plasëse ishte vendosur në gomën e pasme të mjetit. Blutë e Tiranës po hetojnë për ndonjë konflikt të mundshëm për shkak të profesionit, ndërsa po verifikohen pamjet filmike të kamerat e sigurisë në zonën ku ndodhi ngjarja. Pavarësisht hetimeve të kryera, ende nuk është bërë i mundur identifikimi e kapja e autorëve.

Aksidenti kalimtarin, bie në pranga

kreu i PS në Përrenjas LIBRAZHD - Policia e Librazhdit ka arrestuar kryetarin e Partisë Socialiste të Përrenjasit, Haxhi Çollakun, pasi ai akuzohet se mëbrëmjen e së martës ka përplasar me makinë një kalimtar. Çollaku ishte duke drejtuar mjetin në aksin rrugor Përrenjas-Librashd, teksa ka aksidentuar një këmbësor, shtetasin me inicialet A.V., 54 vjeç, i cili ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Ndërkohë, ngjarja në fjalë u bë publike edhe në faqen zyrtare të "Facebook" të ish-kryeministrit Sali Berisha. Qytetari dixhital i shkruante Berishës se kalimtari kishte ndërruar jetë, ndërkohë që policia bën me dije se 54-vjeçari ndodhet në gjendje të rëndë për jetën, ndërsa akuzonte Çollakun se ia kishte hedhur fajin viktimës.

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest ne burg" në mungesë për 26-vjeçarën Avdjol Dobi, administrator i kompanisë "DH-Albania", e cila me dokumente të falsifikuara fitoi tenderin e "Unazës së Re". Masa e sigurisë nga gjykata është dhënë me kërkesë të prokurorisë. Burime nga grupi hetimor bëjnë të ditur se mbi Dobin rëndojnë 3 akuza: mashtrimi që ka



Avdjol Dobi

Skandali me tenderin e Unazës së Re, gjykata jep burg në mungesë për administratorin e "DH-Albania"

lidhje me skandalin e Unazës, falsifikim dokumentesh si dhe pastrim parash. Kjo e fundit është referuar më datën 13 dhjetor 2018 nga Drejtoria e Policisë së Tiranës. Por, në masën e sigurisë të kërkuar në gjykatë për Dobin, prokuroria thotë se ka dyshime që 26-vjeçarit të

ketë kryer një sërë transakcioneve të dyshuara. Avdjol Dobi është shpallur në kërkim policor që prej zbulimit të skandalit për "DH-Albania" nga emisioni "Të Paekspozuarit" në "News 24" Ky falsifikim e ka ndihmuar kompaninë offshore "Dunwell Haberman" të fitojë lotin prej

18 milionë euro të tenderit për rindërtimin e Unazës së Re, duke krijuar imazhin e rremë se kjo është një kompani 20-vjeçare dhe me eksperiencë në projektet e infrastrukturës. E vërteta është se kjo kompani është themeluar në 25 qershor të vitit 2013, vetëm dy muaj përpara zhvillimit të

tenderit. Në sistemin TIMS, Dobi nuk rezultoi të jetë larguar nga Shqipëria, por tri herë thirrjeve të prokurorisë për t'u paraqitur nuk u është përgjigjur. Në lidhje me hetimet, pak ditë më parë u mor në pyetje në prokurori ish-kreu i ARRSH-së, Afrim Qendro, i cili është shkarkuar nga detyra. Pas zbulimit të skandalit, Autoriteti Rrugor Shqiptar pezulloi ndërtimin në lotin e parë tek Unaza e Re.

Prokuroria e Krimeve të Rënda përfundon hetimet, zbardhet dinamika e ngjarjes në Elbasan

Sulmi tek tregu agroushqimor, si e goditi Suel Çela me "Audi" patrullën e policisë

Djali i biznesmenit Petrit Çela e bashkëpunëtorët akuzohen për "Vrasjen e punonjësve të policisë" mbetur në tentativë

Klodiana Lala

TIRANË

Prokuroria për Krime të Rënda ka përfunduar hetimet lidhur me sulmin e rëndë ndaj Policisë së Shtetit, ngjarje kjo e ndodhur në shtator të vitit 2017, në hyrje të tregut agroushqimor në Elbasan. Marjus Lulaj alias Suel Çela, djali i pronarit të tregut agroushqimor dhe dy miqtë e tij, Enea Bekteshi e Kelmend Xhaferri do të përgjigjen përpara drejtësisë, për akuzën e "Vrasjes së punonjësve të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim. Në dosjen e prokurorisë që disponon "Gazeta Shqiptare" thuhet se mesditën e 18 shtatorit 2017, të pandehurit Bekteshi dhe Kelmendi, punonjësit të tregut, përçollën për në Rinas djalin e pronarit Marjon, bashkë me familjen. Drejt aeroportit, ata udhëtuan me dy automjete, njëra tip "Audi" me targë AA478 PV dhe tip "Range Rover" me targë AA 040 OJ, në pronësi të biznesmenit Petrit Çela. Në kthim, përpara se të hynin në tunelin e Krrabës, policia rrugore ndaloi për verifikim automjetin tip "Audi", që drejtohej nga Kelmend Xhaferri. Pas kësaj, ata vijuan rrugën. Në këtë kohë, në tunelin e Krrabës udhëtonte drejt Elbasanit edhe një automjet tip "Fiat Punto" që drejtohej nga Kristaq Peqini dhe si pasagjer Sokol Tola. Brenda tunelit, ata vunë re se drejt Elbasanit po udhëtonin njëri pas tjetrit tri automjete. Pasagjerit në mjetin e fundit, tip "Golf 6", ata i kishin parë në dorë një armë zjarri pistoletë, me të cilën godiste xhamin e makinës së tij në formë kërcënuese ndaj tyre, duke e përsëritur këtë veprim disa herë. Duke u ndjerë të kërcënuar, pasi u është afruar edhe drejtuesi i automjetit "Range Rover", Sokol Tola i ka telefonuar punonjësit të Policisë, Ervin Ballaci. "Koli jam më ndihmo, se më kanë dalë dy makina e më kanë bllokuar rrugën në brendësi të tunelit. Është një 'Range Rover' dhe një 'Audi' me ngjyrë të zeze. Jam i frikë-

POLICËT E DËMTUAR NGA VEPRJA PENALE

- 1.GJERGJ OSHAFI
- 2.GERALD AGALLIU
- 3.HENRI RUCI
- 4.ERVIN BALLACI



Suel Çela



Përplasja në Elbasan

Gomonia me 1 ton drogë në Vjosë, kapen 2 trafikantët

FIER - Një ditë pas sekuesterimit të gomones me 1 ton kanabis në grykëderdhjen e lumit Vjosa, policia ka vënë në pranga autorët. Ka qenë një bashkëpunim i ngushtë mes autoriteteve policore, duke nisur që nga Guardia Di Finanza e Italisë me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe policinë të Fierit, Vlorës, Lezhës e Elbasanit. Sipas burimeve zyrtare, falë punës hetimore intensive e të mirorrganizuar nga një grup i posaçëm hetimor i Drejtorisë Hetimore Qendrore në Policinë e Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Fier; në bashkëpunim me Prokurorinë për Krime të Rënda dhe me Drejtoritë Vendore të Policisë Vlorë, Lezhë e Elbasan, u bë e mundur zbardhja e tentativës për trafik ndërkombëtar të një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike. Si rezultat i hetimeve janë arrestuar në flagrancë shtetasit me iniciale A.A., 39 vjeç dhe E. Xh., 33 vjeç.

AKUZAT NDAJ TË PANDEHURVE

- 1.Marjus Lulaj (Suel Çela) akuzohet për "Vrasje e punonjësve të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë kryer në bashkëpunim.
- 2.Enea Bekteshi, akuzohet për "Vrasje e punonjësve të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë kryer në bashkëpunim dhe "Prodhim dhe shitje e narkotikëve".
- 3.Kelmend Xhaferri akuzohet për: "Vrasje e punonjësve të Policisë së Shtetit" mbetur në tentativë kryer në bashkëpunim, "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive", "Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit" dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit".

suar", - ka thënë ai. Pas këtij njoftimi, shërbimet e policisë kriminale që udhëhiqeshin nga zvdrejtori i policisë, Elbasan, Gjergj Oshafi, të cilat mbështeteshin edhe nga dy grupe "Shqiponja", dolën në aksion duke bllokuar hyrjedaljet kryesore të qytetit. Në rrugën para tregut agroushqimor, punonjësit e policisë konstatuan në lëvizje në kah të kundërt me ta, automjetin "Range Rover" dhe i bënë shenjë të ndalonte. Nga krahu i pasagjerit zbriti një person me një radiomarrëse në dorë, të cilën tentoi t'ia linte rojës së tregut. Por veprimi u ndalua nga policia. Nga verifikimet rezultoi se automjeti ndodhej në pronësi të biznesmenit Petrit Çela dhe personat që udhëtonin në të u identifikuan si Ledio Zabeli dhe Endri Copja. Policia vendosi i'i shoqëronte, edhe pse ata kundërshtojnë ashpër. Në këto momente, mbërrin me shpejtësi një automjet tip "Audi", me targë AA 795 EP, i cili hyri me shpejtësi mes makinave të policisë, duke goditur

njërin prej tyre. Nga hetimet e prokurorisë, rezultoi se në drejtim të këtij mjeti ishte Suel Çela, djali i biznesmenit Petrit Çela. Pas këtij momenti, dera e tregut u kyç, për disa kohë derisa mbërriti pronari. Këto veprime, - sipas prokurorisë vunë në rrezik jetën e oficerëve të policisë, të cilët ndodheshin në detyrë e për këtë arsye të pandehurit, duhet të japin llogari përpara gjykatës. Në dosje bie në sy fakti, se të pandehurit, Çela, Kelmendi dhe Bekteshi janë hetuar edhe për dy ngjarje të tjera kriminale të ndodhura në Elbasan. Bëhet fjalë për masakrën e 3 shkurt 2016, ku në lagjen "Emin Matraxhiu" janë vrarë me armë zjarri, Agron Çajpa, Eno Bedalli, Ardit Sinakolli dhe janë plagosur disa persona të tjerë, si dhe ngjarjes, e datës 6 qershor 2016, ku në plagosën, Bledar Muça dhe Matilda Kermezo. Por, prokuroria nuk ka gjetur prova për implikimin e tyre në këto krime të rënda.

KORÇË - Brenda pak orësh janë shënuar tri grabitje në Korçë. Mësohet se grabitjet kanë ndodhur gjatë orëve të para të mëngjesit të djeshëm. Një prej bizneseve të grabitura është një fabrikë për prodhimin e letrave, e cila ndodhet në dalje të qytetit. Autorët kanë arritur të marrin një sasi të konsiderueshme lekësh

Tri grabitje brenda disa orësh në Korçë, bastisen 3 biznese dhe një banesë

nga kasaforta që ndodhej në një prej zyrave në katin e dytë të fabrikës, e cila ruhej me roje. Biznesi i dytë i grabitur me hidrosanitare ndodhet në aksin rrugor Korçë-Dishnicë ku autorët kanë vjedhur 30 mijë lekë të reja. Ndërsa, në fshatin Bul-

garec është grabitur banesa dhe biznesi, furrë buke në pronësi të Artur Proit, ku autorët kanë vjedhur rreth 10 mijë euro si dhe 400 mijë lekë të reja. Sipas policisë, dyshohet që grabitjet të jenë kryer nga një grup i strukturuar kriminal.

Eugena Tomini: Nuk kemi raste të rënda

Arrin në 30 numri i të prekurve nga fruthi, fëmijët nën 2 vjeç më të prekurit

Deri më 22 janar, numri i të prekurve nga fruthi në vendin tonë ka arritur në 30. Këto të dhëna janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik në një kohë që disa ditë më parë u shënuan një tjetër rast vdekje nga fruthi në QSUT. Sipas specialistes së këtij institucioni deri më tani nuk ka asnjë rast në gjendje të rëndë. "Kemi një total prej 30 rastesh pozitiv, nga 45 raste të dyshuara. 15 janë në proces për testim,

ndërkohë që nuk kemi raste të rënda, e grupmosha më e prekur është ajo nën 2 vjeç, të cilëve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit ende s'iu ka ardhur momenti të vaksinohen kundër fruthit", tha në një deklaratë për mediat Eugena Tomini, specialiste e sëmundjeve infektive në ISHP.

APELI I ISHP

Instituti i Shëndetit Pub-

lik ju ka bërë thirrje të gjithë prindërvë të vaksinojnë fëmijët e tyre sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit për grupet që janë më të rrezikuara. "Jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit që nuk janë vaksinuar ndaj fruthit apo nuk kanë marrë dy doza të vaksinës, duhet të vaksinohen. Vaksinimi ndaj fruthit është mbrojtja më e mirë për parandaluar fruthin dhe komplikacionet

që vijnë prej tij. Për shkak se kjo periudhë e vitit sjell rritje të numrit të rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më i rëndësishëm vaksinimi, për të parandaluar përhapjen e fruthit", thekson Instituti i Shëndetit Publik.

MASAT

Masat e ndërmarra nga ISHP për mbrojtjen nga fruthi janë: izolimi në pavione të caktuara në spitale dhe



vetëizolimi për rastet ambulatorë; masa standarde të kontrollit të infeksionit dhe ato të transmetimit nëpërmjet ajrit; përdorimi i mjeteve të mbrojtjes personale;

vaksinimi i personelit shëndetësor; monitorim i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj fruthit; gjurmim dhe vaksinim brenda 72 orëve i kontakteve etj.

Shkencat e Natyrës, protestë të Ministria e Arsimit. Disa fakultete vazhdojnë bojkotin

Studentët e Juridikut paralajmërojnë grevë urie: Qeveria të reflektojë sa më shpejt

Gjeologjiku: 15 ditë afat për shfuqizimin e VKM-së së 2014

Ditën e djeshme, një pjesë e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe të Mjekësisë kanë protestuar para Ministrisë së Arsimit dhe madje kanë hedhur vezë e bojë drejt godinës. Ndërkohë bojkoti i mësimit ka vijuar të Filologjikut, Gjeologjikut, Shkencat e Natyrës, Shkencat Sociale e Juridikut, në një kohë që ky i fundit ka paralajmëruar grevë urie ditën e hënë. Ata i kanë lënë disa ditë afat qeverisë për të plotësuar 8 kërkesat dhe të rrezojë ligjin për arsimin e lartë. "Kur u diskutua greva, kemi qenë disa persona që e kemi marrë vendimin, që ne do dalim të parët në grevë. Gjithashtu, shumica e studentëve janë për shkallëzim proteste, dhe meqë greva është mjeti më demokratik, kanë vendosur; shumica e studentëve atje sipër dhe të tjerë që kemi diskutuar që janë për grevë. Të reflektojë sa më shpejt kryeministri para se studentët të ndërmarrin këtë masë ekstreme", thotë një prej studentëve. Sipas tyre, prishmëritë e tyre nuk janë arritur e kjo do të çojë me vullnet të plotë në përkallëzim të protestës. "Duhet kjo masa ekstreme pasi ne nuk kemi marrë asnjë feedback, nuk mund të tërhiqemi pas kësaj që ndodhi. Po shohim që nuk kemi asgjë të qartë dhe nuk po na informon askush për këto 8 pikat tona. Studentët kanë vendosur; është vendim individual futja në grevën e urisë. Prishmëritë tona kanë qenë që të rrezohet ligji i arsimit të lartë. Kërkesat tona janë të qarta, ligji nuk u rrezua e ne do ta vazhdojmë këtë me grevë urie. Studentët kanë kërkuar mbështetje edhe nga pjesa tjetër e tyre në mënyrë që të bashkohen deri në plotësimin e kërkesave. "Të dielën ose të hënë nisim grevën e urisë. Kush e ndjen mund t'i bashkohet grevës. Nuk e kemi vendosur vendin ku do hapim grevën. Kërkojmë rrezimin e ligjit të arsimit të lartë", thonë studentët.

SITUATA E GJEOLGJIKU
Fakulteti i Gjeologji- Minerave i ka lënë një afat prej 15 ditësh qeverisë për shfuqizimin e VKM-së së vitit 2014 që kalon për administrim këtë



fakultet, nga Ministria e Arsimit tek Ministria e Drejtësisë. Nëse nuk plotësohet kërkesa e tyre, studentët e pedagogët e këtij institucioni do të bojkotojnë plotësisht më-

simin. Sipas tyre mungesa e statusit të godinës ka sjellë edhe mungesë totale të investimeve. Përpos shfuqizimit të VKM-së, ata kanë kërkuar edhe plotësimin e 8 kërkesave



të parashtruara qeverisë si dhe rrezimin e ligjit për arsimin e lartë.

BOJKOTI NË SHKODËR

Ndërkohë, bojkoti vazhdon

në të gjitha fakultetet e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Studentët mblidhen çdo mëngjes në hollat dhe klasat e fakulteteve të ndryshme duke këmbëngulur në

BOJKOTI

Bojkoti vazhdon në të gjitha fakultetet e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Studentët mblidhen çdo mëngjes në hollat dhe klasat e fakulteteve të ndryshme duke këmbëngulur në plotësimin e kërkesave të tyre. Sakaq, gjatë natës studentët më aktivë qëndrojnë në një sallë për të dëshmuar se janë të gatshëm ta çojnë përpara rezistencën.

plotësimin e kërkesave të tyre. Sakaq, gjatë natës studentët më aktivë qëndrojnë në një sallë për të dëshmuar se janë të gatshëm ta çojnë përpara rezistencën.

Zbardhen datat e provimeve kombëtare për vitin shkollor 2018-2019

Të gjithë nxënësit që do t'i nënshtrohen provimeve kombëtare për vitin shkollor 2018-2019, tashmë mund të njihen me datat e testeve. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot udhëzimin e Ministrisë së Arsimit me datat përkatëse. "Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2018-2019, do të zhvillo-

hen si më poshtë: Lënda Gjuhë e huaj, më 10 qershor 2019; Lënda Gjuhë shqipe, më 18 qershor 2019; Lënda Matematikë, më 21 qershor 2019. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet

më 14 qershor 2019", thuhet në udhëzim. Në këtë të fundit bëhet me dije gjithashtu se gjuhët e huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. "Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si

gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2. Nxënësit e klasave të 9-ta të seksioneve dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze japin provim gjuhësh përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta", nënvizon MASR.



Kompensimi për kërkesat e përsheptuara, pronarët marrin këstin e radhës

Pronarët, 258 milionë lekë për dosjet e viteve 2016-2018

Lista me 70 përfutuesit në të gjithë vendin

Agjencia e Trajtimit të Pronave shpërndan rreth 258 milionë lekë për 70 pronarë, të cilët kanë përfituar nga skema e pagesës së përsheptuar. Përfutuesit janë në të gjithë vendin dhe do të kenë brenda pak ditëve në llogaritë e tyre këstin e radhës. Përmes një njoftimi për mediat, Agjencia e Trajtimit të Pronave bën të ditur se është lëvruar kësti i radhës për subjektet që kanë përfituar kompensim financiar me kërkesë të veçantë gjatë viteve 2016-2018. "Agjencia e Trajtimit të Pronave njofton se në fillim të vitit buxhetor 2019 ka përfunduar procedurën për lëvrimitin e këstit të radhës për 70 subjekte, që kanë përfituar kompensim financiar me kërkesë të veçantë gjatë viteve 2016-2018, nga të cilët një subjekt përfiton këstin e katërt, dhjetë subjekte përfitojnë këstin e tretë dhe 59 subjekte përfitojnë këstin e dytë", - thuhet në njoftimin e ATP-së. Sipas njoftimit, vlera totale e fondit, të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që do të lëvrohet menjëherë si kësti i radhës për 70 subjektet përfitues është 257'842'178,19 lekë". Agjencia e Trajtimit të Pronave u bën të ditur subjekteve të interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transferave bankare në ditë në vazhdim", - thuhet në njoftim.

PAGESAT E PËRSHEPTUARA

Janë vendosur tri afate pagesash të përsheptuara. Pagesë brenda një viti, brenda tre vjetësh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti, pronari merr 20 % të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese, të cilat shprehin vullnetin



Jonida Baçi, drejtorja e Agjencisë së Trajtimit të Pronave

PAGESAT E PËRSHEPTUARA

1. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 1 viti, atëherë ai përfiton 20% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
2. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 3 vjetësh, atëherë ai përfiton 30% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
3. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 5 vjetësh, atëherë ai përfiton 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
4. Prioritet do të kenë aplikimet që kërkojnë të kompensohen financiarisht brenda 1 viti, nga kërkesat për kompensim brenda 3 apo 5 vjetësh.

për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit finan-

ciar, pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të ven-

dimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

Largimi masiv i shqiptarëve nga vendi

Ish-kryeministri Berisha, takim me përfaqësues të Bankës Botërore

Ish-kryeministri Sali Berisha zhvilloi dje një takim me dy përfaqësues të Bankës Botërore, zonjën Florence Charlier dhe zotën Ali Khadr kryesisht. Gjatë këtij takimi Berisha, Charlier dhe Khadr kanë biseduar për çështjen e largimit të shqiptarëve, situatën ekonomike në vend si dhe për disa çështje të tjera, të cilat Berisha i quan shqetësuese. Me anë të një postimi në "Facebook", Berisha ka publikuar foto dhe temat e diskutuara në takim. "Çështje kryesore të këtij takimi ishin: Largimi masiv i shqiptarëve nga vendi i tyre, largimi nga vendi dhe mosardhja e investitorëve perëndimorë në Shqipëri këto vitet e fundit, korrup-



sioni i papërbajtur i jash-tëzakonshëm i lidhur direkt me familjen kryeministore dhe qeveritarët, dhjetëfishimi i qmimit të ndërtimit të rrugëve dhe veprave të tjera publike, ndërkohë që kostoja e ndërtimit është rritur më pak se 40% dhe ndarja e këtyre qindra e qindra milionë euro nga kompanitë me pushtetarët", - shkruan Berisha

në 'FB'. Sipas ish-kryeministrit Berisha, vendi dhe ekonomia janë tejet të kërcënuar nga borxhi publik, i cili sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare të borxhit për shkak të PPP ka arritur në 83% dhe pritet të jetë mbi 90% në dy-tri vitet e ardhshme, ndërkohë që ky borxh sipas BB dhe FMN në vitin 2013 ishte 62.7%.

LISTA ME 70 PËRFUTUESIT

DAVID	STERMASI	TIRANE
GENTIAN	NEBIAJ	
CAUSH	KOÇIU	FIER
FATMIR	SINANI	TIRANE
RAMAZAN	SARAÇI	DIBER
BASTRI	KANANI	FIER
ALDI	TOPÇIU	TIRANE
HEKTOR	CANAJ	VLORE
CAUSH	KOÇIU	FIER
SKERDI	MUÇA	FIER
XHELADIN	XHAKA	DIBER
NUSRET	RIZVANOLLI	TIRANE
VIOLETA	PETRELA	TIRANE
EGEREM	BAJRAM	KORÇE
HEKTOR	CANAJ	VLORE
NEXHMI	BLACERI	KORÇE
LILJANA	MATO	KORÇE
GENTIAN	NEBIAJ	TIRANE
FIRUZE	ARAPI	ELBASAN
BASHKIM	GRUBLESHE	TIRANE
MERITA	KARAPICI	TIRANE
FATBARDHA	BARO	FIER
MERITA	KARAPICI	TIRANE
MAJLINDA	VRESHTAZI	VLORE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
HILDA	BASHA	TIRANE
ALI	MALOKU	TIRANË
ANAMARI	LAMLIKA	TIRANË
KUJTIM	MAÇI	TIRANË
SUZANA	BILALI	SHKODËR
MIMOZA	ÇELA	TIRANË
XENJA	LUKA	SHKODËR
XENJA	LUKA	SHKODËR
RRAPO	NAKA	FIER
ERVIN	HABILAJ	FIER
BARDHYL	BILIBASHI	TIRANË
HAMDI	MALAJ	TIRANË
NERIMAN	BEQAJ	TIRANË
HILDA	BASHA	TIRANË
SILI	TAVANXHIU	FIER
JOLLANDA	RUCI	FIER
HILDA	BASHA	TIRANË
SEJDEFE	HALLUNI	SHKODËR
ERVIN	DELIALLISI	TIRANË
ERVIN	DELIALLISI	TIRANË
ENES	SOKOLI	SHKODËR
EDMOND	DYLQESHI	TIRANË
ARMAND	BOÇI	TIRANË
PRANVERA	SHEHU	FIER
SEFEDIN	LAMÇE	BERAT
HAVA	GODINA	DURRES
MEHMET	BYLYKBASHI	TIRANE
SOKOL	SHALA	TIRANE
ANASTAS	ARALLAMBI	DURRES
FATMIRA	TOSKA	TIRANE
BRUNILDA	SHIROKA	TIRANE
FITNET	BILALI	SHKODËR
ATNAN	SIMIXHI	TIRANE
MIRJAM	PEÇI	TIRANE
ROZETA	PLASARI	TIRANE
AGIM	KRAJA	SHKODËR
FATMIRE	POJANI	TIRANE

PUNESIMI ME KONTRATE VENDIMI

Punësimet me kontratë të përkohshme për 2019 në institucionet shtetërore

Vendimi i ri/ 1335 vende pune në administratë

Lista e detajuar e pozicioneve të punës

Gjatë vitit 2019, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme në njësitë e qeverisjes qendrore do të jetë 1335. Vendimi i Këshillit të Ministrave është miratuar dhe publikuar në Fletoren Zyrtare dhe parashikon që tri ministritë me numrin më të lartë të punësimit të punonjësve të përkohshëm të jenë janë Ministria e Drejtësisë me 499 të tillë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me 362 dhe Ministria e Brendshme me 120.

INSTITUCIONET

Në vendim është përcaktuar se në ILDKP do të jetë një specialist dhe në Kryeministri do të jenë 28 specialistë. Sipas vendimit, katër specialistë do të jenë në sekretariat teknik të Komisionit të Dhënies së Dëshmisë të Statusit të Naftëtarit, një specialist tek aparati i

Ministritë për Evropën dhe Punët e Jashtme, tre specialistë të Departamentit të Administratës Publike, pesë specialistë të Drejtorisë së Dëshmipërblimit të ish-të Përndjekurve Politikë dhe një punonjës protokoll-arkivi në aparatet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

PAGAT

Punonjësit me kontratë në funksionin "specialist" paguhen në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik, të përcaktuar në strukturën e institucionit, por në asnjë rast, kategoria e pagës së tyre në institucionet e pavarura dhe aparatet e minis-

trive nuk kalon nivelin IV-a dhe, në institucionet në varësi të institucioneve qendrore, nivelin IV-b. Përjashtim bëjnë specialistët e aparatit të Kryeministrit, të cilët paguhen në kategorinë e pagës të nivelit III-b. Sipas vendimit për pranimit e reja të punonjësve me kontratë në funksionet "specialist", që

nuk plotësohen me punonjës, të cilët kanë lidhur kontratë në vitin paraardhës dhe puna e të cilëve është e pandërprerë, zbatohen dispozitat e vendimit nr. 812, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e studentëve të ekscelencës në institucionet e administratës shtetërore, jashtë

shërbimit civil, për vitin 2019". Ndërkohë, mbulimi i efekteve financiare për punonjësit me kontratë bëhet nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2019 të njëjtit të qeverisjes qendrore. Për punonjësit me kontratë të Shtëpisë së Pushimit Durrës (MB), të Shtëpisë së Pushimit të SH-ISH-it dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij. Për punonjësit, të cilët kanë lidhur kontratë në vitin paraardhës, puna e të cilëve nuk është ndërprerë dhe për të cilët është bërë regjistrimi në sistemin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, efektet financiare fillojnë më 1 janar 2019.

1335 VENDE PUNE NË ADMINISTRATË

Gr.	Emri i institucionit	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudha kohore
02	Kuvendi	10		
	Shërbimi i Botimeve Parlamentare	3	Specialist redaktimi	6 orë/ditë vjetore
	Shërbimi i marrëdhëneve me publikun	1	Specialist për mediat	6 orë/ditë vjetore
	Sektori i Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar	1	Punonjës protokoll arkiv	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Shërbimit Mirëmbajtjes	2	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Shërbimit Mirëmbajtjes	3	Tëknikë të mesëm	6 orë/ditë 6-mujore
3	Kryeministria	57		
	Aparati	28	Specialist	8 orë/ditë vjetore
	Aparati	29	Operator	6 orë/ditë vjetore
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	23		
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	5	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Punonjës arkivi	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Operator për EDRMS	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	4	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	1	Drejtues motorbarke	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	6	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë vjetore
6	Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë	34		
	Aparati i Ministrisë	5	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë vjetore

	Aparati i Ministrisë	1	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës protokoll	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	5	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Specialist në sekretariatet e SAJTES	8 orë/ditë vjetore
	Agencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë vjetore
	Instituti i Transportit	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme Detare	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Agencia për Eficientë dhe Energjisë	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Autoriteti për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	1	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore
	Inspektori Shtetëror Teknik dhe Industrial	2	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Inspektori Shtetëror Teknik dhe Industrial	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë vjetore
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	4	Tëknikë të specialiteve të ndeshme	6 orë/ditë vjetore

10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	362		
	Aparati i Ministrisë (Drejtorja e Drejtimit të Pronës)	1	Punonjës protokoll/arkivi	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	5	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Punonjës protokoll/arkivi	8 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	7	Specialist	8 orë/ditë 6-mujore
	Aparati i Ministrisë	3	Specialist arkivi	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Mirëmbajtjes/sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Fotokopjuer	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë Drejtorja e Pagesave dhe Dëshmipërblimeve	5	Specialist	8 orë/ditë vjetore
	Degët e Thesant	24	Sanitar	4 orë/ditë vjetore
	Degët e Thesant Vlore	1	Sanitar	3 orë/ditë vjetore
	Dega e Thesant Lushnje	1	Sanitar	2 orë/ditë vjetore
	Dega e Thesant Durrës	1	Sanitar	5 orë/ditë vjetore
	Dega e Thesant Tiranë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë vjetore
	Dega e Thesant Tiranë	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë vjetore
	Dega e Thesant Skrapar	3	Specialist	8 orë/ditë 6-mujore
	Agencia e Arsimt, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Agencia e Arsimt, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme Tatimeve	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	250	Punonjës shërbimi	8 orë/ditë 6-mujore
	Drejtorja e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	23	Arkivist/protokollist	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	6	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Agencia e Administrimit të Pasurive Skaektuarra dhe Kualifikimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Punonjës arkivi/protokoll	6 orë/ditë vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	2	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë	4	Specialist	8 orë/ditë 6-mujore
	Agencia e Trajtimt të Koncesioneve	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë	4	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë	1	Lulishtar	6 orë/ditë vjetore
	Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
12	Ministria e Kulturës	38		
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	6 orë/ditë vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Tëknik i mesëm	6 orë/ditë vjetore

Aparati i Ministrisë	1	Operator EDRMS	6 orë/ditë	vjetore
Galeria Kombëtare e Arteve	2	Vëzhgues/ciceron	4 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	2	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	2	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Biblioteka Kombëtare	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	10 muaj
Zyra e parkut Arkeologjik Burrim	3	Punëtor mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	maj-tëtor
ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	8 muaj
ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
ZAK Parku Arkeologjik Bylis	1	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	8 muaj
Muzeu i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik Korçë	1	Biletashitës	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë	2	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	prill-nëntor
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë	1	Biletashitës	6 orë/ditë	prill-nëntor
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës	2	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	prill-shator
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër	1	Sanitare	4 orë/ditë	vjetore
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore

Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Berat	2	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	maj-shator
Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Berat	1	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	vjetore
Muzeu Kombëtar Gjeithi	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	vjetore
Muzeu Kombëtar Gjeithi	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
AQSHF	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
AQSHF	1	Restorator	6 orë/ditë	vjetore
Çirku Kombëtar	1	Sanitar	6 orë/ditë	10 muaj
Qendra e Muzeumeve Berat	1	Vëzhgues	4 orë/ditë	6 muaj

13 Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	52			
Aparati i Ministrisë	6	Operator	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	3	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	4	Operator	6 orë/ditë	vjetore
Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldast	6 orë/ditë	janar-mars shtator-dhjetor
Qendra Kombëtare Mirëmbajtjes, Zhvillimit Famijeve	2	Mjek	6 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	5	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Ndihmëkuzhinier	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Ndihmëkuzhinier	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e Famijeve Shkollore Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Shtëpia e Famijeve Shkollore Tiranë	1	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Mjek	4 orë/ditë	vjetore
Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Ndihmëkuzhinier	4 orë/ditë	vjetore

Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Mjek	4 orë/ditë	vjetore
Qendra e Zhvillimit Durrës	2	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje	1	Psikolog	4 orë/ditë	vjetore
Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje	2	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
Qendra Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje	1	Punonjës social	4 orë/ditë	vjetore
Drejtorja e Përgjithshme e SHSSH-së	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja e Përgjithshme e SHSSH-së	6	Operator	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja e Përgjithshme e SHSSH-së	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja e Përgjithshme e SHSSH-së	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore

14 Ministria e Drejtësisë	499			
Aparati i Ministrisë	1	Operatorë	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	2	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor	2	Arkivist	6 orë/ditë	vjetore
Instituti i Mjekësisë Ligjore	2	Laborantë/ndihmëspjektor	6 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Shërbimi për Çështjet e Btësisëmeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Shërbimi për Çështjet e Btësisëmeve	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Qendra e Botimeve Zyrtare	20	Operator	8 orë/ditë	1 muaj

Qendra e Botimeve Zyrtare	20	Operator	8 orë/ditë	1 muaj
ALU/LZNI	398	Specialistë	8 orë/ditë	vjetore
ALU/LZNI	54	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	vjetore
ALU/LZNI	14	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
15 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	23			
Aparati i Ministrisë	5	Preparatorë	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	3	Punonjës protokoll/arkivi	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Postier	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Lulshar	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Elektricitet	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	2	Punonjës ngarkim-shkarkim	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	2	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	4	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	2	Operatore EDRMS	6 orë/ditë	vjetore

16 Ministria e Brendshme	120			
Shtëpia e Pushimit Durrës	6	Kuzhinier	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Ndihmëkuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	30	Kamener	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	18	Punëtor Restoranti	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Teknik	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	6	Receptionist	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	12	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	10	Punëtor kuzhine	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	25	Punëtor hoteli	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektricitet	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Lavanteri	8 orë/ditë	01.6.2019-10.09.2019
Prefekti i Qarkut Tiranë	2	Arkivist	6 orë/ditë	vjetore

17 Ministria e Mbrojtjes	1			
Autonietë i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
18 Shërbimi Informativ Shtetëror	24			
SHISH (shtëpitë e pushimit)	6	Kuzhinier	8 orë/ditë	15 qershor-15 shtator
SHISH (shtëpitë e pushimit)	2	Banaker	8 orë/ditë	15 qershor-15 shtator
SHISH (shtëpitë e pushimit)	12	Sanitar	8 orë/ditë	15 qershor-15 shtator
SHISH	4	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore

20 Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	15			
Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	1	Specialist	6 orë/ditë	vjetore
Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	14	Punonjës protokoll/arkivi	6 orë/ditë	vjetore

26 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	8			
Aparati i Ministrisë	1	Operator për EDRMS	6 orë/ditë	vjetore
Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore

31 Agjencia Telegrafike Shqiptare	10			
Agjencia Telegrafike Shqiptare	6	Specialist-gazetar	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Telegrafike Shqiptare	3	Specialist-përkthyes	6 orë/ditë	vjetore
Agjencia Telegrafike Shqiptare	1	Teknik	6 orë/ditë	vjetore

57 Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1			
Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore

63 Kolegji i Posaçëm i Apelit	2			
Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	Punëtor mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore

66 Avokati i Popullit	7			
Avokati i Popullit	7	Specialist	6 orë/ditë	vjetore

67 Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	4			
Komisioneri	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Komisioneri	2	Operator	6 orë/ditë	vjetore
Komisioneri	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore

76 Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	1			
Aparati i ILDKPKI-së	1	Inspektor	8 orë/ditë	vjetore



25

VJEÇ, STUDENTËT

Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/ve veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

65

VJEÇ, PRINDËRIT

"Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë", - bën me dije ISSH.

50%

TË MASËS SË PENSIONIT

Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, e përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%.

25%

TË PENSIONIT

Të të ndjerit Kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

Fëmijët jetimë marrin 50% të pensionit që gëzonte i ndjeri

Si bëhet përlllogaritja e masës së pensionit familjar



Pensionin familjar kon siderohet ai pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërkaq, personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri kur është i vetëm, dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili



humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i kërkesës, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëngjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

DOKUMENTACIONI**Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**

- Certifikatë e gjendjes familjare.
- Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës.
- Fotokopje e kartës së identitetit për kërkuesin, ose përfituesit e tjerës.

Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:

- Librezë e punës.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore.
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë.
- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.

Dokumentet që vërtetojnë të qenit në ngarkim të të ndjerit/ndjerës:

- Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar.
- Vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune.
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit.
- Vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë.
- Procesverbal që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale.
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërve e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes.
- Vërtetim nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".
- Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbytje të detyrës gjatë fluturimit.
- Vërtetim që nuk është i punësuar apo vetëpunësuar, për jetimin që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat).

Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit-tip.
- Vërtetim i pagës mesatare neto për vitin e fundit të punës.



Prestige Resort' mbetet gjithnjë një atraksion për turistët vendas e të huaj në cdo sezon të vitit. Pak ditë më parë, resorti ka mirëpritur një mysafire të vecantë. Aktorja Amerikane Sincerely Ward, e cila ka luajtur së fundi në filmin 'Fast and Furious 2' thotë se ka mbetur e mrekulluar nga vizita në 'Prestige Resort', një vizitë në fakt surprizë e kaluar pa rënë në sy në Shqipëri.

Aktorja amerikane ka postuar në instagamin e saj foto nga ambientet e 'Prestige Resort', ndërsa shkruan se mezi pret të rikthehet atje në verë.

"Kjo është Shqipëria. Prestige Resort në bregdet është një vend shumë i bukur. Ushqim i shijshëm, staf i mrekullueshëm dhe peisazh i shkëlqyer. Mezi pres të shkoj atje në sezonin e verës" - shkruan aktorja amerikane, bashkëngjitur fotove në Prestige Resort.

Fotot e publikuara nga Sincerely Ward në instagran kanë zgjuar kuriozitetin e shumë prej ndjekësve të saj, të cilët shkruajnë se do të shtojnë Shqipërinë në listën e destinacioneve të verës.

Krahas 'Fast & Furious 2', Sincerely Ward ka luajtur edhe filma të tjerë të njohur amerikanë, si Bad Boys II, Spider-Man 3, Match Made in Heaven, ndërsa aktualisht moderon reality shoë Wags of Atlanta.



Aktorja e njohur e 'Fast&Furious 2' në 'Prestige Resort': I mrekullueshëm

Aktorja amerikane: Mezi pres të shkoj atje në sezonin e verës



PENSIONI FALIMJAR PËRFITUESIT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Kujdes, ja rastet kur pagesa mund të ndërpritet

Cilat janë 5 kategoritë që përfitojnë pension familjar

Kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet

Voltiza Duro

Bazuar në ligjin "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", qytetarët që plotësojnë kriteret e përcaktuara mund të përfitojnë pension familjar. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kategoritë përfituese, kushtet si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët e interesuar.

KATEGORITË PËRFITUESE

Përkatësisht janë 5 kategori që mund të marrin pagesën e pensionit familjar. Këtë të fundit mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paafte për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar. Ndërsa në të gjitha ato raste kur e veja nuk është pjesëtarë e pensionit familjar dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Gjithashtu, përcaktohet edhe moshë kur përfitohet pensioni familjar nga i/e veja. Pension familjar mund të përfitojë e veja që është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç; që nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur moshën 55 vjeç. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve, kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që është i paafte për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Të gjithë ata jetimë që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paafte për punë mund të përfitojnë pension familjar. "Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur



Foto ilustruese

moshën 65 vjeç ose janë të paafte për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paafte për punë", bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtij të fundit edhe nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të, trajtohen si jetimë dhe mund të marrin pension familjar. Në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

DOKUMENTACIONI

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për të fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar, përveç kërkesës, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot skedën e plotë informative për të marrë këtë pagesë si dhe kërkesën që duhet të bëjnë paraprakisht të interesuarit. Respektivisht individët duhet të

paraqesin certifikatën e gjendjes familjare, fotokopjen e letres së njoftimit elektronik për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë, si dhe certifikatën e vdekjes së të ndjerit në të cilën duhet të jetë shënuar edhe shkaku i vdekjes. Gjithashtu, aplikuesi për pension familjar duhet të dorëzojë edhe dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës, si librezë e punës apo vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj. Bashkëngjitur dokumentacionit të mësipërm, duhet të dorëzohen edhe dokumentet që vërtetojnë qenët në ngarkim të të ndjerit si dhe: vërtetim i vazhdimësisë në punë dhe llojin e punës që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, vërtetim që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë, vendim i KMCAP-it për paafësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune etj. Nënvojzë se në kërkesën për pension familjar, jetimi që

PENSIONI FAMILJAR

Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paafte për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.



Foto ilustruese

5 KATEGORITË PËRFITUESE

- E veja që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur 55 vjeç.
- Burri i ve, që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është i aftë të punojë, ka mbushur moshën 60 vjeç.
- Jetimët e moshës 18-25 vjeç që studiojnë apo janë të paafte për punë.
- Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paafte për punë.
- Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të.

mesatare neto, për vitin e fundit të punës. Ndërsa të gjithë ata persona që përfitojnë nga ligji "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve Politikë" duhet të dorëzojnë

vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi kohën e vuajtjes së dënimit, çdo dokument tjetër që vërteton të qenët në punë dhe vërtetim mbi faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij.

BLUE TOOTH
TRASHËTHËME
MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

© 2018



25

VJEÇ, STUDENTËT

Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se në momentin që i/ve veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

65

VJEÇ, PRINDËRIT

"Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë", - bën me dije ISSH.

50%

TË MASËS SË PENSIONIT

Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, e përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%.

25%

TË PENSIONIT

Të të ndjerit Kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

Fëmijët jetimë marrin 50% të pensionit që gëzonte i ndjeri

Si bëhet përlllogaritja e masës së pensionit familjar



Pensionin familjar kon siderohet ai pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërkaq, personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri kur është i vetëm, dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi, i cili



humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i kërkesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë

ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëngjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

DOKUMENTACIONI

Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Certifikatë e gjendjes familjare.
- Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës.
- Fotokopje e kartës së identitetit për kërkuesin, ose përfituesit e tjerës.

Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:

- Librezë e punës.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore.
- Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë.
- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.

Dokumentet që vërtetojnë të qenit në ngarkim të të ndjerit/ndjerës:

- Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar.
- Vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune.
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit.
- Vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë.
- Procesverbal që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale.
- Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërve e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes.
- Vërtetim nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".
- Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit.
- Vërtetim që nuk është i punësuar apo vetëpunësuar, për jetimin që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat).

Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit-tip.
- Vërtetim i pagës mesatare neto për vitin e fundit të punës.

Përgjigjja që i habiti të gjithë, reagimi i prezantueses


Love story!

Ja e vërteta e romancës së Jonida Vokshit dhe DJ Sardit

Detajet që tregojnë lumturinë e çiftit

Egla Xhemali

Lajmi se mes moderator es simpatike Jonida Vokshi dhe DJ Sardit, ka më shumë se shoqëri, ka bërë mjaft bujë në media. Ndonëse asnjëri prej tyre nuk e konfirmoi, dyshimet mediatike dhe të fansave sa vijnë edhe shtohen më tepër. I ftuar tek emisioni 'Familja' para dy ditëve, Sardi ka lënë të kuptohet se mes tyre ekziston diçka. I pyetur nga Turjan Hyska nëse ishte e vërtetë që është në një lidhje me të, DJ është përgjigjur me një fjalë të vetme, duke lënë të kuptohet një përgjigje pozitive. 'Mbase', duke buzëqeshur. Mirëpo nga ana e saj, në një prononcim për "Prive", Jonida Vokshi e ka mohuar vërtetësinë e këtij thashethemi. "Pikë së pari shumë-shumë faleminderit që më pyetët. Pikë së dyti nuk ka asgjë të vërtetë në këtë histori", ka qenë përgjigja e Vokshit, duke deklaruar se romanca me Sardin, në njëfarë forme është një trillim. Burime për "Gazeta shqiptare" kanë pohuar se mes dy yjeve të ekranit bukurshes prezantuese dhe DJ më të pëlqyer të momentit ekziston një romancë. Gjithashtu, edhe nga postimet e të dyve në rrjetet sociale kuptohet se ka lindur një ndjenjë e bukur mes tyre. Jonida është përpjekur gjithmonë që jetën e saj private ta mbaj larg mediave rozë megjithatë këtë herë duket se përpjekjet kanë dështuar. Për Sardin mund të themi se është një nga VIP-at më të komentuar të momentit për love-story-t që kanë përfunduar me zemër të thyer. Të gjithëve ju kujtohet se si lindi dashuria me Jorën në korridoret e 'Dance with me' dhe vijoi edhe jashtë skenës së baletit. Jo rrallë herë Sardi dha sinjale nga llogaritë e tij sociale, me ndonjë foto e me mesazhe të koduara që ishte në një romancë dhe pse donte ta mbante raportin jashtë medias rozë. Ne zbuluam se ata kanë qenë në hedhjen e një hapi tepër të rëndësishëm, të cilin Sardi e ka prishur: U zbulua gjithashtu se ata kanë qenë gati për të



zyrtarizuar lidhjen e tyre në fejesë, por Sardi e kishte tradhtuar bukuroshen. Ako-

ma nuk dihet shkaku i kësaj tradhtie, pse Sardi preferoi të zgjidhte këtë lloj mënyre për

t'u shkëputur përfundimisht nga e dashura e tij. Nuk i dihet pse DJ nuk i ecën asnjë



raport megjithatë sa i përket romancës me Jonidën do na duhet të presim sinjale nga

çifti. Ata duken të lumtur e ne urojmë që Sardi më në fund të ketë gjetur shpirtin binjakë!



Ezhveshur si statujë! Fotot e klipit të Norës dhe Erës po bëjnë namin në rrjet

Këngëtarja e njo hur, Era Istrefi është drejt përfundimit të xhirimeve të këngës së saj më të re që do ketë në bashkëpunim me motrën e saj Norën. Xhirimet po bëhen në Kosovë, vendlindjen e këngëtares dhe projekti i ri pritet të publikohet së shpejti. Një ndër gjërat që na kanë bërë shumë përshtypje është paraqitja e dy motrave. Era Istrefi ka bërë disa ndryshime në 'look' dhe të gjithëve na ka mahnitur. Ishte Nora ajo e cila ka ndarë me ndjekësit në 'Instagram' disa fotografi nga xhirimet e klipit, teksa një gjë të tillë së fundmi e ka bërë edhe Era. Era Istrefi ka publikuar një foto në 'Instagram' ku shfaqet në një sfond lejla me në qendër Erën gjysmë e zhveshur në formën e një statuje. "Statuja e lodhjes", ka shkruar Era në mbishkrimin e fotografisë, duke bërë të ditur se ka qenë mjaft e lodhur gjatë xhirimeve. Nisur nga të gjitha këto imazhe, po na bëjnë akoma më kuriozë për projektin e tyre dhe mezi po e presim.



Gjendet sozia e Butrint Imerit, zbuloni për kë nga personazhet e famshëm bëhet fjalë

Prej dy javësh jemi nën jehonën e sfidës më të famshme të momentit në 'Instagram' "10yearchallenge". Njerëzit e thjeshtë dhe ata publikë janë bërë pjesë e kësaj sfide duke risjellë foto të tyre të një dekade më parë dhe kemi qeshur pafund. Por, Bes Kallaku përgjatë këtyre ditëve ka postuar në profilin e tij në 'Instagram' foto ku janë të vendosur dy personazhe të njohur që sipas tij kanë ngjashmëri me njëri-tjetrin. E një ndër personazhet që u bë pjesë e kësaj sfide nga Besi ishte edhe Butrint Imeri. Këngëtarit të njohur, aktori i ka gjetur jo një, por dy sozi, fillimisht aktorin protagonist në serialin e famshëm turk "Ertugrul" dhe më pas futbollistin e famshëm të Sevilla, Andre Silva. Kush prej tyre i ngjan më shumë?



Dhurata Dora në një lidhje dashurie? Mësoni kush i aka rrëmbyer zemrën këngëtares

Këngëtarja e njohur, Dhurata Dora gjithmonë është treguar e kujdesshme që jetën e saj personale të mos e ngatërron me atë profesionale. Dhurata ka zgjedhur që të fokusohet vetëm tek karriera e saj muzikore pa dashur të japë detaje të tjera të tjera mbi jetën e saj sentimentale, por me sa duket këtë herë këngëtarja nuk ja ka dalë të 'fshihet' aq sa duhet. Portali "arbresh.info", ka zbuluar se këngëtarja e shumë hiteve është në një lidhje dashurie me Shkamb Vokshin, i cili është një ndër menaxherët e një klubi nate në Kosovë. Asgjë nuk është pohuar nga çifti megjithatë qarkullojnë fjalë se mes tyre ka lindur një romancë. Dhurata dhe Shkambi janë duke përjetuar momente të veçanta pranë njëri-tjetrit. Sa i përket konfirmimit të këtij lajmi nga të dashruarit, na ngelet vetëm të presim!



Pas përçarjes së Babastar, Getoar vjen në një bashkëpunim me reperin e njohur

Fero është kthyer shpejt në një prej reperëve më të komentuar në show bizz. Mesa duket reperi i ri do të vijë me një bashkëpunim me reperin mjaft të dashur për të gjithë, Getoar Selimin. Sipas disa burimeve lajmi.net merr vesh se po planifikohet një super duet mes dy reperëve, Ghetto Geasy dhe Fero. Menaxheri i reperit Fero, Mehmet Elshani tha për lajmi.net se kanë raporte shumë të afërta me Getoar Selimin dhe me kënaqësi do të bashkëpunonin me të. Ai nuk e përjashtoi si mundësi një gjë të tillë mirëpo shtoi se nuk ka asgjë konkrete deri në këtë moment. Gjithashtu edhe një prej menaxherëve të BabaStars, Dekorim Sahitin, i cili tha se nuk e kanë njehë për njëherë një plan të tillë. I pyetur nëse kjo mund të ndodhë në ndonjë të ardhme të afërt përgjigja e tij ishte: Gjithçka mund të ndodhë!



Micotakis: Cipras do japë llogari për emrin e Maqedonisë

Nimic: Kundër rinegociimit, dështimi i marrëveshjes së Prespës ka pasoja për dy vendet

Lideri i partisë opozitare greke Demokracia e Re, Kirjakos Micotakis nëpërmjet një mesazhi në profilin e tij në Twitter ka thënë se kryeministri grek Aleksis Cipras do të përgjigjet edhe para popullit edhe para historisë për Marrëveshjen e Prespës me Maqedoninë për çështjen e emrit. Ai shtoi se janë shkelur linjat kombëtare të vendit. Së bashku me porosinë ai ndau edhe video nga fjalimi i tij në Kongresin e 12-të të Demokracisë së Re më 14 dhjetor të vitit të kaluar. "Jeni i detyruar, Cipras të përgjigjeni jo vetëm para maqedonasve dhe i të gjithë popullit grek, por edhe para historisë" - ka

KIRJAKOS MICOTAKIS

"Jeni i detyruar, Cipras të përgjigjeni jo vetëm para maqedonasve dhe i të gjithë popullit grek, por edhe para historisë" - ka paralajmëruar Micotakis kryeministrin grek.

paralajmëruar Micotakis kryeministrin grek. Ndërsa ndërmjetësuasi për çështjen e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë, Metju Nimic, shprehet se nëse Marrëveshja e Prespës dështon të ratifikohet në Kuvendin grek, atëherë do të ketë pasoja të thella për të dyja palët. Në intervistë për

Agjencinë greke të lajmeve, Nimic, shprehet kundër argumenteve që të ketë rinegociim të Marrëveshjes. Ai nënvizoi se nuk beson se një "zgjidhje e shpejtë" do të ishte e mundur. "Unë mund të parashikoj shumë skenarë të ndryshëm që mund të jenë të mundshëm, disa prej tyre mjaft të rrezikshme. Një mar-

rëveshje e re do të marrë vite, jo muaj, pasi të gjitha çështjet (duke përfshirë ndryshimin e emrit të shtetit mbi të gjithë - erga omnes) do të kthehen në tavolinë, pasi ka të ngjarë që do të ketë dinamika të ndryshme politike në të dy vendet, si dhe ndryshime në mjedisin rajonal dhe global", ka vlerësuar ndër të tjera ndërmjetësuasi, Metju Nimic. Ai ka shtuar se "të dy palët kanë punuar në mirebesim për të zgjidhur këtë polemikë që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Përkohshme në shtator të vitit 1995, pothuajse 25 vjet përpejke". Ndërmjetësuasi Nimic, tha se



Lideri i partisë opozitare greke Demokracia e Re, Kirjakos Micotakis

"paqja, siguria dhe miqësia ka më shumë gjasë të ndodhin me këtë marrëveshje sesa me vazhdimin e konfliktit". Nderkohë parlamenti grek ka nisur diskutimet për Marrëveshjen e Prespës. Debatet do të zgjasin dy ditë dhe marrëveshja do të hidhet për votim përfundimtar mbrëmjen e së enjtes. Debatit

pritet të zhvillohet në një atmosferë të elektrizuar. Të enjten, është paralajmëruar një protestë e re para Parlamentit, kundër marrëveshjes. Organizatorët e saj kërkojnë që shkollat dhe bizneset të qëndrojnë të mbyllura, ndërsa qytetarët të nxjerrin në dritare e tyre flamujt kombëtarë të vendosur në gjysmë shtizë.

Lista Serbe kundërshton deklaratat e presidentit kosovar për Mitrovicën

Hashim Thaçi: Bashkimi kombëtar, porosi e Isa Boletinit

Kadri Veseli: Andej e këtej Ibrit do jetë një Kosovë

Ditën e djeshme u përmbushën 103 vjet që nga vrasja e Isa Boletinit, njërit nga udhëheqësit kryesorë të kryengritjeve shqiptare, ndërsa në nder të tij, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka bërë një dedikim. Ai ka përmendur edhe porosinë që Isa Boletini ka lënë për çlirimin e trojeve etnike shqiptare. "U bënë 103 vjet nga vrasja e Isa Boletinit, njërit prej udhëheqësve kryesorë të kryengritjeve shqiptare. Bashkimi kombëtar dhe fuqizimi i kombit tonë ishte porosia që na e la Isa Boletini. Përpejket e tij një shekull më parë për çlirimin e trojeve etnike përbëjnë ende frymëzim për shumë breza të rinj dhe amaneti i Isa Boletinit dhe patriotëve të tjerë, që dhanë jetën për bashkimin e shqiptarëve, na obligon edhe sot që të punojmë pareshur për përmbushjen e aspiratave tona", ka shkruar Thaçi. Edhe kreu i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në Akademinë Përkujtimore të vrasjes së heroit të kombit, Isa Boletini, tha se sa herë vjen janari kujtohen rëniet dhe vdekjet e njerëzve të mëdhenj të kombit tonë: Skënderbeut e Ismail Qemalit, por edhe luftëtarët e vonshëm të lëvizjes sonë kombëtare, që ranë po në janar: Vëllezërit Gërvalla, Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuh Berisha, Zahir Pazajiti, Hakif Zejnullahu e Edmond Hoxha. "Jemi bërë bashkë për të kujtuar e nderuar një personalitet të madh të Kosovës, i cili po ashtu ra në janar, heroin e Mitrovicës, heroin e Kosovës, heroin e gjithë kombit shqiptar, Isa Boletini. Porosia jetësore e Isa Boletinit na flet qartë dhe drejtë, na shumë se kurrë: nuk ka jetë të mirë për individin, pavarësisht gjendjes së kombit. Na mund të jemi



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

mirë, veç kur kombi dhe shteti i kanë punët mirë. Kjo është dashuria e vërtetë për atdheun", theksoi Veseli. Kreu i Kuvendit të Kosovës tha se gjenerata e tanishme ka për mision që Kosova përgjithmonë të jetë e lirë, shtet i pavarur dhe sovran, anëtarë në familjen e shteteve sovrane, në OKB, NATO dhe BE. "Ne si gjeneratë e dimë se nga kemi ardhur, çfarë trashëgojmë dhe ku duam të shkojmë. Ne i dimë detyrat me të cilat na ka ngarkuar historia dhe nuk e kemi ndërmend, për asnjë moment, të heqim dorë prej tyre. Dhe nuk ka

vend ma adekuat se sa Mitrovica për ta dhënë këtë zotim. Nuk ka, sepse Mitrovica është qyteti emblemë i kombit. Mitrovica është testamenti i Isa Boletinit. Sot dhe përgjithmonë, andej dhe këndej Ibrit do të jetë një Mitrovicë dhe një Kosovë", tha Veseli. Ai shtoi se Kosovën nuk e frikësojnë sfidat që i dalin përpara dhe as dialogu e ballafaqimi me Serbinë. "Ne hymë në dialog për ta fuqizuar Kosovën, shtetin dhe kombin tonë. Bashkë me partnerët dhe aleatët tanë të mëdhenj në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dhe të jeni të sig-

urtë se kemi me ia dalë. Do të fitojmë", theksoi kryeparlamentari Veseli. Nga ana tjetër, deklaratat e presidentit, Hashim Thaçi se bashkimi i Mitrovicës është proces i pandalshëm, ka ngjallur reagimin e kryetarit të Listës Serbe, Goran Rakić, i cili e quajti këtë deklaratë si sulm më të ri ndaj paqes në Kosovë. Rakić, përmes një deklaratë, thotë se në emër të popullit serb e porositë Thaçin, se serbët kurrë nuk

do të lejojnë bashkimin e jugut dhe veriu të Mitrovicës, pasi siç thotë, kjo do të ishte një "parakusht për pastrim etnik nga qyteti i vetëm në të cilin serbët i shpëtuan pastrimit etnik në vitin 1999". Ai thotë se serbët janë gjithnjë e më të quajti këtë deklaratë si sulm më të ri ndaj paqes në Kosovë. Rakić, përmes një deklaratë, thotë se në emër të popullit serb e porositë Thaçin, se serbët kurrë nuk

dojnë boshnjakët, shqiptarët, romët, goranët, turqit dhe egjiptianët. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se bashkimi i qytetit të Mitrovicës, është proces i pandalshëm. Ai të martën, priti kryetarin e komnës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiti, i cili ia dorëzoi Thaçit një peticion me rreth 17 mijë nënshkrime të qytetarëve që kërkojnë bashkimin e qytetit të Mitrovicës.

Haradinaj: Taksa ndaj Serbisë mund të jetë përgjithmonë

Aleksandar Vuçiq: Deklaratat e kryeministrit kosovar, sinjal i keq për gjithë rajonin

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe nuk do shfuqizohet. Edhe pas takimit që pati sot me ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, Haradinaj tha se taksa mund të mbetet në fuqi përgjithmonë, po qese nuk arrihet një marrëveshje për njohjen e Kosovës nga Serbia. "Biseda ka qenë dialogu, zhvillimet rreth dialogut të ndërlihdura me taksonë. Kemi dëshirë ta heqim edhe për shkak se është synim i ShBA. E kishim hequr sot sikur të mbërrinin një marrëveshje

gjithëpërfshirëse për njohje", theksoi Haradinaj, duke shtuar se taksa mund të mbetet në fuqi përgjithmonë. Nderkohë, SHBA vazhdimisht ka kërkuar pezullimin e tarifës së vendosur ndaj produkteve serbe. Në një përgjigje dhënë "Zërit" nga ambasada e SHBA-së në Kosovë kanë thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë apeluar tek udhëheqësit kosovarë për heqjen e taksnë në mënyrë të vazhdueshme. Nderkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha të martën se deklaratat e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, se

tarifa ndaj mallrave serbe nuk do të shfuqizohet derisa Beogradi ta njohë Kosovën janë "lajm dhe sinjal i keq për të gjithë rajonin". Duke folur për mediat në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, Vuçiq tha se Serbia është e fortë dhe do të "luftojë deri në fund". "Ata mund ta bëjnë këtë dhe të mbasin edhe më të aleatët e afërt të dikujt", tha Vuçiq. Presidenti serb njoftoi se të mërkurën do të takojë kancelaren gjermane, Angela Merkel, të cilën, siç ka thënë, do ta lusë që ta ndihmojë Serbinë për shumë çështje përfshirë Kosovën.

8658 persona të huaj janë larguar me detyrim nga Gjermania

Kthim rekord azilkërkuesish në shtetet e BE, rritet me 25% në 2018 numri i refugjatëve

Vitin e shkuar, autoritetet gjermane kanë kthyer më shumë refugjatë sa kurrë më parë në shtetet e tjera të BE. Vendi kryesor i kthimit është Italia. Me Greqinë nga ana tjetër ka pasur probleme. Nga janari deri në nëntor 2018 kanë qenë gjithsej 8658 azilkërkues me detyrim për t'u larguar nga Gjermania, që janë kthyer pas, shkruan "Süddeutsche Zeitung" në botimin e saj të së hënës. Në vitin 2017 ka pasur vetëm 7102 përcjellje azilkërkuesish. Gazeta i referohet për informacionin e saj përgjigjes së Ministrisë



Federale të Punëve të Brendshme ndaj një pyetjeje të deputetes së partisë E

Majta në Bundestag, Ulla Jelpke. Kuota e refugjatëve të kthyer, në fakt, u rrit nga 15 përqind në 2017-ën, në 24,5 përqind në 2018-ën. Sipas të dhënave të Ministrisë, vitin e kaluar një në tre procedura azilimi të Zyrës Federale për Migrimin dhe Refugjatët (Bamf) ishte një nga të ashtuquajturat raste të Dublinit. Në një rast të tillë duhet të sqarohet, nëse është kompetent për kërkesën e azilit të aplikuesit një shtet tjetër i BE. Sipas direktivës

Dublin III të BE, si rregull për kërkesën e azilit të një refugjati është kompetent shteti anëtar, në të cilin refugjati regjistrohet pas mbërritjes së tij në Evropë. Sipas Süddeutsche Zeitung, Gjermania bëri në 11 muajt e parë të 2018-ës 51,558 kërkesa në vendet anëtare të Marrëveshjes Dublin III. Prej tyre u pranuan 35,375. Vendi kryesor për kthimet në territorin evropian, sipas raportit ishte Italia: aty u kthyen gati një në tre

azilkërkues. Kthime në Hungari nuk pati asnjë dhe në Greqi u kthyen vetëm pesë vetë. Të dyja këto vende kritikohen për mënyrën si i trajtojnë refugjatët. Qeveria gjermane ankohet më tej se autoritetet e Athinës kanë refuzuar shumicën e kërkesave për kthim pas - "kryesisht për shkaqe që nuk qëndrojnë". Ministri gjerman i Brendshëm, Horst Seehofer është përpjekur që ta rrisë numrin e deportimeve të azilkërkuesve të refuzuar, në kuadër të një politike që synon uljen e numrit të refugjatëve dhe përmirësimin e aftësisë së Zyrës Federale të Migrimit për të trajtuar si duhet kërkesat e azilit.

SHKURT
Ende në kërkim, shuhen shpresat për futbollistin britanik Sala

Sala
Shuhen shpresat për të gjetur gjallë futbollistin e Cardiff City, Emiliano Sala dhe pilotin e avionit. Sipas John Fitzgerald, kreu i kërkimeve nga ajri në ishujt e Kanalit Britanik, "edhe personi më i stërvitur në botë" do të mbijetonte vetëm pak orë në ujë. "Fatkeqësisht, personalisht nuk mendoj se ka shpasa. Në këtë periudhë të vitit, kushtet atmosferike jashtë janë shumë të vështira nëse je në ujë", tha Fitzgerald. Sulmuesi 28-vjeçar Sala dhe piloti David Ibbotson udhëtonin nga Franca në drejtim të Uellsit të hënën, kur avioni u zhduk nga radarët. Përpara se avioni i Salas të zhdurkej, ky i fundit u nisi familjarëve të tij një mesazh audio në WhatsApp. Mediat argjentinas raportojnë se 28-vjeçari u tha familjarëve se ndihej i frikësuar. "Jam në një avion dhe duket sikur do shpërbëhet", tha sulmuesi. Sipas BBC, gjatë ditës së mërkurë 3 avionë dhe një helikopter ishin pjesë e operacionit të kërkimit të avionit Piper Malibu. Fatkeqësisht deri më tani nuk ka ende asnjë gjurmë të mjetit, ndërsa kërkimet vijojnë. Sala ishte nisur drejt kryeqytetit të Uellsit, pasi firmosi një kontratë prej 15 milionë paund me ekipin e Cardiff, duke u larguar nga klubi francez i Nantes.

Tymoshenko do garojë në zgjedhjet presidenciale të Ukrainës

Ish-Kryeministria e Ukrainës, Yulia Tymoshenko njoftoi se do të kandidojë në garën për president të vendit në zgjedhjet e Marsit. Tymoshenko, e cila ka qeverisur me Ukrainën nga viti 2005 deri në vitin 2010, akuzon udhëheqjen aktuale si përgjegjëse për pagat e ulëta dhe zgjatjen e konfliktit në lindje të vendit. Ajo e përshkroi Ukrainën si shtetin më të varfër në Evropë dhe një nga më të korruptuarit në botë. Anketimet e fundit e vendosin Tymoshenkon para presidentit aktual Petro Poroshenko. Yulia Tymoshenko kandidoi për presidente edhe në vitin 2010, mirëpo humbi nga rivali i saj Viktor Yanukovich, i cili e la postin, pas protestave masive që kërkonin lidhje më të afërta me Perëndimin. Gjatë kohës që Yanukovich ishte në pushtet, Yulia Tymoshenko u dënua me shtatë vjet burg për korrupsion

Amerika ka 1.900 raketa të gatshme të lëshohen brenda 30 minutave

Lufta e ftohtë, SHBA kishte 1100 shënjestra bërthamore, dy në Shqipëri

Arsenali rezervë rrezikon zhdukjen e gjysmës së njerëzve në tokë

A rkvivat e NSA-së amerikane, publikuan pak kohë më parë një listë të deklasifikuar të objektivave bërthamore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që nga viti 1956, dhe që përfshinte mbi 1100 vende në Evropën Lindore, Rusi, Kinë dhe Korenë e Veriut. Harta e publikuar më poshtë, tregon të 1100 objektivat bërthamore nga ajo listë, dhe tregon se sa katastrofike mund të kishte qenë një luftë bërthamore midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. Edhe pse lista e shënjestrave bërthamore është klasifikuar, ajo nuk ka pse të duket edhe aq dramatike. Shtetet e Bashkuara kanë ende rreth 1.900 raketa bërthamore të vendosura në raketa (dhe me mijëra të tjera në rezervë), të gatshme për t'u lëshuar në çdo moment, dhe të afta për të goditur objektivat e tyre brenda 30 minutave. Nga 1100 raketat, 2 prej tyre ishin drejtuar kundër Shqipërisë komuniste, e cila deri në vitin 1968, kur u largua zyrtarisht nga Traktati i Varshavës, ishte zyrtarisht pjesë e bllokut lindor të udhëhequr nga Moskë. Konkretisht, njëra prej raketave bërthamore amerikane ishte parashikuar të godiste Tiranën, dhe tjetra Kuçovën ose Qytetin Stalin, siç njihet deri në vitin 1991, për shkak se aty gjendej baza e madhe e avionëve luftarakë. Kjo situatë e paqëndrueshme, është jashtëzakonisht e rrezikshme, dhe ka rrezikuar në mënyrë të përsëritur të shkaktojë në mënyrë rastësore një luftë bërthamore. Për më tepër, shumë nga bombat e sotme me hidrogjen, janë qindra herë më të fuqishme, se sa dy bombat atomike të hedhura në Hiroshimë dhe Nagasaki. Nëse do të shpërthente sot një luftë bërthamore, dimri bërthamor mund të vriste shumicën e njerëzve në Tokë. Kjo çon në një pyetje të rëndësishme: Për sa armë bërthamore ka vërtetë nevojë një vend? Shtatë nga nëntë shtetet bërthamore, kanë



Sulmet bërthamore të SHBA-së në Europë, Harta e vitit 1956

përcaktuar se parandalimi kërkon më pak se 300 armë bërthamore, dhe asnjëri prej tyre nuk mund të sulmohet. Megjithatë, jo vetëm që Shtetet e Bashkuara dhe Rusia kanë aktualisht secila nga afërsisht 7.000 mbushje bërthamore - që përbëjnë 90 përqind të arsenalit botëror - por që të dyja vendet janë duke e përshkallëzuar situatën, duke ndërmarrë së fundmi investime masive, për të rritur arsenalin e tyre me armë bërthamore, më të sakta dhe më vdekjeprurëse. Shumë analistë ushtarakë, pajtohen se SHBA-ja dhe Rusia mund të përmbushin lehtësisht nevojat e tyre parandaluese, me shumë më pak armë bërthamore. Madje edhe Pentagoni ka deklaruar, se SHBA-ja nuk ka nevojë për më shumë se 1 mijë armë bërthamore, për të penguar një sulm bërthamor ndaj saj. Ndërsa hartat e mësipërme tregojnë një rreze të

përgjithshme të shkatërrimit bërthamor, modelet e motit do të luajnë një rol mbi atë sa njerëz do të preken nga pasojat bërthamore. Duke pasur parasysh se moti mund të ndryshojë nga dita në ditë, në qoftë se lëshohet një bombë bërthamore pranë kufirit të një vendi në ditën e gabuar, njerëzit e pafajshëm në vendin fqinj mund të vuanë pasojat e reve radioaktive. Sesa larg dhe në cilin drejtim do të udhëtonin materialet radioaktive, kjo do të varej nga madhësia e bombës dhe moti lokal. Aleks Velershtajn, simulon 2 skenarë të tmerrshëm: Çfarë do të kishte ndodhur nëse të 1100 objektiva bërthamore, do të goditeshin nga një armë bërthamore me një madhësi të caktuar më 29 prill 2016? Në stimulimin e Verelshhtajnit, bomba bëhet më e madhe dhe reja bërthamore përhapet më larg objektivit, në një drejtim që diktohet

nga modelet e motit lokal. Vini re se kjo shfaqje nuk ka treguar ende efektin e dimrit bërthamor: nëse ngrihet mjaftueshëm tymi nga shpërthimet bërthamore lart në stratosferë, ai mund të përhapet në të gjithë planetin tonë, dhe të shkaktojë një epokë mini-akullnajore dhe jetëvjeçare, një kolaps të bujqësisë, dhe potencialisht vrasjen e shumicës së 7.6 miliardë njerëzve në Tokë. Si do të ndryshonte drejtimi i resë radioaktive, nëse objektivat bërthamore do të goditeshin në ditën e gabuar.

prill, 30 prill dhe 1 maj 2016 për të parë se si ndryshon drejtimi i pasojave bërthamore nëse bombat 100 kilotonë secila, do të hidheshin mbi 1.100 objektiva bërthamore (bomba e sotme, janë shumë herë më të fuqishme). Modele të ndryshme të motit, do ta dërgonin renë bërthamore në drejtime të ndryshme çdo ditë. Kushtojni vëmendje të madhe vendeve si Gjermania, Danimarka dhe Finlanda, të cilat mund të goditen me pasojat radioaktive, nëse objektivat bërthamore do të goditeshin në ditën e gabuar.

Marrë nga Bota.al



PAMJE UNIKE NGA UJËVARA E NGRIRË E NIAGARËS

FOTOLAJM

Ujëvara e Niagarës në këtë stinë të vitit është në pjesën më të madhe e mbuluar nga akulli. Një spektakël unik në botë i shkaktohet nga vala e madhe e të ftohtit që ka përfshirë këto ditë brigjet verilindore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Opinion

i Ditës

Investimet e duhura për të trajtuar krizën e kapitalit njerëzor

Nga Kristalina Georgieva

(villon nga faqja 1)


...të ardhmen. Ajo është përqendruar sidomos tek më të varfrit dhe më të pambrojturit - qasjen e tyre në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, asete, vende pune dhe tregje. Në vitet e fundit, ajo ka përfunduar politika dhe investime në fusha kritike për të ardhmen e botës, siç janë luftimi i ndryshimeve klimatike dhe përfitimim e të varfërve nga teknologjia.

Kudo që udhëtojmë - nga Ruanda në Zambia, ose nga Indonezia në vendin tim, Bullgari - shoh ndryshimin që mund të sjellë teknologjia në jetën e njerëzve. Ndikimi është i dukshëm në shumë mënyra, siç janë sistemet e pagesave digjitale ose ekonomia në zhvillim, që sjellin histori të jashtëzakonshme suksesi.

Por ashtu si teknologjia po përmirëson jetën e miliona njerëzve në mbarë botën, ajo po ndryshon gjithashtu edhe natyrën e punës. Raporti Botëror i Zhvillimit 2019 u përqendrua në mënyrën se si inovacioni po ndryshon ose largohet nga vendet ekzistuese të punës dhe po krijon fusha krejtësisht të reja punësimit që para disa vitesh nuk ekzistonin.

Kjo ngre disa pyetje të vështira: Çfarë punësh do të bëjnë njerëzit? Si do t'i mbajnë ata familjet e tyre? Si do ta përbushin ata potencialin e tyre në një botë gjithnjë e më komplekse?

Në kemi mjete të reja të fuqishme për t'i ndihmuar vendet në zhvillim t'i përgjigjen këtyre pyetjeve. Në takimet vjetore të Grupit të Bankës Botërore-FMN në Bali në tetor, ne prezantam Indeksin e Kapitalit Njerëzor Fillimisht duke mbuluar 157 shtete, Indeksi është një masë përmblendhëse e kapitalit njerëzor që një fëmijë i lindur sot mund të presë të arrijë deri në moshën 18 vjeçare,



duke pasur parasysh rreziqet e shëndetit të dobët dhe arsimit ku ai ose ajo jeton.

Indeksi fokusohet në rezultatet në tri fusha kyçe. Së pari, mbijetesja: Cili është probabiliteti që një fëmijë i lindur sot do të mbijetojë deri në moshën pesë vjeçare? Së dyti, shëndeti: A do të nënçmohen fëmijët para moshës pesë vjeçare? A do të jenë ata të shëndetshëm në moshë madhore, të gatshëm për punë, me një bazë për të mësuar gjatë gjithë jetës? Dhe së treti, arsimi: Sa shkollë do të bëjnë fëmijët dhe, ajo që është më e rëndësishmja, sa do të mësojnë ata?

Indeksi i Kapitalit Njerëzor është unik sepse fokusohet në

treguesit e lidhura me produktivitetin, siç janë mbijetesja e fëmijëve, moshja e shkollimit, vitet e shkollimit të përshtatura me të mësuarit dhe mbijetesja e të rriturve dhe vendos një kufi të drejtpërdrejtë midis rritjes së ardhshme ekonomike dhe rezultateve më të mira shëndetësore dhe arsimore. Mbi të gjitha, ai paraqet një pasqyrë të qartë për liderët se sa më produktivë mund të jenë punëtorët e tyre kur janë të shëndetshëm, të arsimuar dhe të pajisur me aftësitë e nevojshme për një treg pune që ndryshon me shpejtësi.

Një vend mund të shënojë midis 0 dhe 1 në indeks, me 1 që paraqet kufirin më të mirë të mundshëm të

arsimit të plotë dhe shëndetit të plotë. Në indeksin tonë të parë, vlera mesatare për botën ishte vetëm 0.56. Kjo do të thotë se, në të 157 vendet e mbuluara, fëmijët e lindur sot do të rriten për të qenë afërsisht sa gjysma e më produktives që ata mund të jenë.

Implikimet për rritjen ekonomike - dhe për rrjedhojë për zvogëlimin e varfërisë - janë të mëdha. Nëse një vend ka një rezultat prej 0.50, GDP-ja e ardhshme për punëtor mund të jetë dy herë më e lartë nëse ai vend ka arritur kufirin. Gjatë një gjysmë shekulli, kjo do të thotë deri në 1.4 pikë përqindjeje të rritjes së GDP-së çdo vit.

Investimi në njerëz është akoma më urgjent për shkak të dy trendeve sfiduese globale. Së pari, rritja globale po ngadalësohet. Raporti ynë Perspektivat Ekonomike Globale, i publikuar më herët këtë muaj, me të drejtë titullohet "Qiej të Errët". Rritja globale është zbutur - në vitin 2019 pritet të ngadalësohet në 2.9%, nga 3% që ishte në vitin 2018. Dhe rritja në tregjet dhe ekonomitë në zhvillim pritet të bjerë me 4.2%, i njëjti ritëm si në vitin 2018.

Së dyti, ritmi i reduktimit të varfërisë po ngadalësohet. Raporti ynë Poverty and Shared Prosperity zbuloi se në vitin 2015, viti më i fundit me të dhëna të fuqishme, varfëria ekstreme arriti në 10%, nivelin më i ulët i regjistruar në histori. Por 736 milionë njerëz që jetojnë ende në varfëri të skajshme do të jenë më të vështirë për t'u arritur. Shkalla e varfërisë në zonat që vuajnë nga brishtësia, konflikti dhe dhuna u rrit në 36% në vitin 2015, nga një nivel i ulët prej 34.4% në vitin 2011 dhe kjo përqindje ka gjasa të rritet.

Investimi në kapitalin njerëzor mund të ndihmojë në nxitjen e rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike. Por kjo nuk është vetëm fusha e ministrave të shëndetësisë dhe arsimit. Krerët e shteteve, ministrat e financave, drejtorët ekzekutivë dhe investitorët duhet t'i bëjnë urdherisht prioritet këto investime.

Nëse veprimi tani, ne mund të krijojmë një botë ku të gjithë fëmijët mbërrijnë në shkollë të mirë ushqyer dhe të gatshëm për të mësuar: ku ata mund të rriten për të qenë të shëndetshëm, të aftë dhe produktivë dhe ku ata kanë një shans për të përbushur potencialin e tyre.

Fëmijët e sotëm e meritojnë këtë të ardhme. Punëdhënësit e së nesërme do ta kërkojnë atë. Liderët e botës duhet të veprimin menjëherë tani për ata.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinion *i* Ditës

Erdogani në Moskë: Plane të reja për Sirinë?

Nga "Deutsche Welle"

(vijon nga faqja 1)

... presidentët në fund të vitit 2016 kanë bashkuar forcat dhe së bashku me Iranin thirrën procesin e "Astanasë", që duhet t'i jepte fund gjakderdhjes në Siri. Por pas njoftimit të presidentit Donald Trump për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria, secili aktor në rajon po rishikon planet e tij. Në tavolinën e shahut qëndrojnë tri tema: krijimi i një zone të sigurisë në veri të Sirisë në lindje të lumit Euftrat, një operacion i mundshëm i trupave turke në Manbidxh dhe rritja e ndikimit të islamistëve të afërt me Al-Kaidën në Idlib.

Tek të gjitha këto tema për Turqinë ka një vijë të kuqe: organizata e krijuar nga kurdët, PYD/YPG. Partia e Unionit Demokratik, PYD dhe krahu i saj i armatosur, Njësitë Kurde të Mbrojtjes, YPG kanë lidhje të ngushta me PKK, që ndodhet në listën e terrorit në Turqi, BE dhe SHBA. Turqia e sheh PYD/YPG si krahuin sirian të PKK-së dhe e kategorizon si organizatë terroriste. Ndryshe nga partneri i NATO-s, SHBA që u mbështet tek YPG-ja në luftën kundër milicëve të IS-it. Që Uashingtoni i trajnoi dhe armatosi kurdët e YPG-së ka qenë një halë në sy për Turqinë. Qëllimi zyrtar i PYD/YPG-së është krijimi i një rajoni autonom në veri të Sirisë, në jug të kufirit me Turqinë.

"ZONA E SIGURISË"

Turqia kërkon krijimin e një zone të sigurisë, me qëllim që të krijojë një zonë të ndërmjetme mes kufirit të saj dhe rajonit sirian ku zhvillohen luftime. Qëllimi është që luftëtarët e armatosur kurdë të YPG-së të largohen nga ky rajon dhe të hapin vend për refugjatët sirianë, që duhet të kthehen nga Turqia në vendin e tyre. Sipas Dr. Murat Yesiltas nga "Fondacioni për Studime Politike, Sociale, dhe Ekonomike" (SETA) me qëndër në Ankara bëhet fjalë për rreth 300.000 kurdë që u detyruan të marrin aratinë prej YPG. Drejtori i studimeve të sigurisë në SETA kujton artikullin e botuar si i ftuar nga presidenti Erdogan në "New York Times", ku ai shprehet se Turqia në pjesët veriore të dominuara nga kurdët në veri të Sirisë do të krijojë "këshilla komunale" dhe do t'i ftojë kurdët, që nuk kanë marrë pjesë në luftime terroriste të marrin pjesë në këtë proces.

Sipas ekspertëve, presidentët Trump dhe Erdogan duket se janë të një mendimi për krijimin e një zone të sigurisë. Sipas qarqeve diplomatike, bëhet fjalë për një zonë sigurie prej 32 kilometrash. Krijimin dhe kontrollin e këtij korridori Turqia do ta marrë vetë përsipër. Nuk dihet, nëse amerikanët



e mbështetin këtë pozicion turk.

Dr. Kerim Has, ekspert nga Moska është i mendimit, se ka pasur disa ujdë me presidentin Trump për fatin e kurdëve sirianë. Turqia nuk do të veprojë ushtarakisht kundër luftëtarëve të YPG-së dhe kurdët do të tërhiqen nga zona e sigurisë për të kaluar në jug të Sirisë, sipas Kerim Has. Sipas tij, ka gjasa që në fund të ngrihet një Kurdistan Sirian si në Veri të Irakut, me ndihmën dhe miratimin e Turqisë.

Por çfarë mendon Moska për një zonë të tillë të sigurisë? Kerim Has kujton qëndrimin e Rusisë, sipas të cilit, regjimi i Asadit duhet të fitojë kontrollin në të gjitha zonat e Sirisë. Edhe Moska parasheh për kurdët një lloj autonomie, por më shumë një autonomi kulturore. Eksperti i sigurisë, Murat Yesiltas është i mendimit, se regjimi i Asadit

nuk do të ishte në gjendje të ruante stabilitetin dhe sigurinë në lindje të Euftratit. Prandaj Rusia është e hapur ndaj alternativave.

MANBIDXH

Një tjetër vatër e nxehtë është Manbidxhi pranë Euftratit, në anën perëndimore të lumit. Erdogan kërcënon prej muajsh me një operacion ushtarak. Arsyeja: Qyteti që banohet më së shumti nga arabë, u mor nga YPG pas luftimeve kundër IS-it dhe ndryshe nga premtimi amerikan dhënë Ankarasë qyteti nuk u lëshua nga YPG. Trupat e Asadit janë stacionuar vetëm në periferi të qytetit, pjesërisht me milicët e YPG-së. Rusia dëshiron që ky qytet të jetë nën kontrollin e Asadit. Sipas ekspertit Kerim Has, Rusia nuk ka për të dhënë dritë jeshile për një ofensivë të Turqisë në Manbidxh. Edhe nëse e bën këtë, atëherë me një kusht të

qartë, që rajoni t'i dorëzohet së më së shpejt Asadit. Një "po" e Moskës do t'i mundësonte Erdoganit të paraqiste një triumf ushtarak para zgjedhjeve komunale në mars. Nga ana tjetër, Turqia do t'i mbetej borxh Rusisë.

IDLIB

Sa të rëndësishme janë planet në lindje të Euftratit për Erdoganin, po kaq i rëndësishëm është për Putinin fati i Idlibit, mendon eksperti për Rusinë, Kerim Has. Rusia dhe Turqia nënshkruan një marrëveshje në shtator të vitit të kaluar, ku sipas së cilës, bastioni i rebelëve, Idlib të mbetej një zonë e çmilitarizuar. Po ashtu u ra dakord që të tërhiqeshin të gjitha armët e rënda dhe "të gjithë luftëtarët radikalë". Prioritet kishte tërheqja e organizatës Hajat Tahrir Al-Sham, një degë e afërt me Al-Kaidën. Ankaraja nuk e donte një operacion ushtarak në Idlib dhe një valë të re refugjatësh në vendin e saj. Por kushtet e kësaj ujdje nuk janë përmbushur. Hajat Tahrir Al-Sham e ka zgjeruar influencën e saj pas luftimeve të ashpra kundër grupeve rebelë të mbështetura nga Turqia. Putin ka gjasa t'i kujtojë Erdoganit kushtet e marrëveshjes së vitit të kaluar sipas motos "ose ju e bëni operacionin dhe e nxirrni jashtë Hajat Tahrir Al-Sham, ose ne do ta bëjmë këtë", thotë eksperti Kerim Has.

Turqia kërkon krijimin e një zone të sigurisë, me qëllim që të krijojë një zonë të ndërmjetme mes kufirit të saj dhe rajonit sirian ku zhvillohen luftime. Qëllimi është që luftëtarët e armatosur kurdë të YPG-së të largohen nga ky rajon dhe të hapin vend për refugjatët sirianë, që duhet të kthehen nga Turqia në vendin e tyre.

HOROSKOPI

DASHI

Stimulimi intelektual është afrodiaku më i madh për ju. Sot do të dëshmoni se keni pikëpamje të ndryshme me njeriun e zemrës, por kjo nuk duhet të bëhet shkas për marrëveshje.

DEMI

Ju do të ndiheni intelektualisht energjik këtë mëngjes. Duhet të vendosni kontakte me dikë që gjithmonë ka nocione interesante. Ekziston mundësia që nëse punoni së bashku, ju mund të zgjidhni një mister shumë të bezdisshëm.

BINJAKET

Durimi juaj do të testohet sot kur dikush të shtypë butonin e pauzës për disa nga planet tuaja më emocionuese. Ky është një realitet që duhet t'ju bëjë të punoni për më shumë pavarësi.

GAFORJA

Nëse ju duhet të jepni ndonjë lajm negativ ose kritikë konstruktive për një person sot, përpiqini ta bëni atë gjatë darkës. Shogërimi me të tjerët mund të bëhet një sfidë sot, sepse mendjen e keni të disa çështje të vështira.

LUANI

Duhet t'i besoni gjykimin tuaj sot dhe mos u mbështetni në mendimet dhe opinionet e njerëzve të tjerë. Nëse dikush me një reputacion të dyshimtë kalon nga rruga juaj, sytë dhe veshët tuaj janë burimet më të mira të informacionit.

VIRGJERESHA

Bëhuni gatë që të përballeni me një nga filozofitë më të rëndësishme. Diçka do të ndodhë që t'ju dëshmojë se kurrë nuk mund të mendoni se gjërat do të mbeten të njëjta. Mos harroni se udhëtimi do të jetë më i rëndësishëm se destinacioni.

PESHORJA

Angazhimi në diçka kulturore është një ide e madhe sot. Ju keni pasur gjithmonë një kureshtje të fortë për gjërat që nuk janë prekur shpesh, por tani kjo kureshtje është veçanërisht më intensive.

AKREPI

Të sfidosh limitet është diçka që ju jeni mësuar ta bëni, por duhet të jetë diçka që integrohet në shumë fusha të jetës suaj, sidomos sot. Universi ju jep guxim që ju nevojitet për të treguar kurajë në çështjet e dashurisë.

SHIGJETARI

Dikush do të kërkojë të përfitojë duke tërhequr atënj tuaj analitike sot, por edhe ju nuk do të bëni rezistencë. Dita e sotme shënon fillimin e një ndryshimi në perceptimet tuaja. Jeni të gatshëm për të parë të dyja anët e medaljes, përpara se të dilni në përfundime.

BRICJAPI

Edhe pse dashuria është e rëndësishme për ju, sot mund të ndjeni nevojën për të qëndruar vetëm. Ka ardhur momenti që të kaloni më shumë duke reflektuar mbi çështjet profesionale.

UJORI

Sot do t'ju ofroni miqve tuaj, të afërme dhe kolegëve argëtimin më të mirë që mund të kërkojnë. Jeni ju që e drejtoni skenën në këto momente, ndaj tregoni deri në fund talentin tuaj. Mos lejoni askënd që t'ju eklipsojë.

PESHQIT

Ana juaj më idealiste, romantike po filon të ketë më shumë kontroll mbi jetën tuaj tani, gjë që tregon për vetëvlerësimin tuaj. Kuptoni se kur shihni më të mirën të gjithçka, ju shihni automatikisht më të mirën në veten tuaj. Njerëzit

SULMUESI TREGON AMBICIET

Edhe pse për rreth 1 vit e gjysmë, e ka kaluar tek Legia e Varshavës në Poloni, dhe tek Levante në Spanjë, Armando Sadiku duket se nuk është shkëputur kurrë nga ekipi i Luganos. Sulmuesi i Kombëtares ka filluar të tregojë se është i rëndësishëm për ekipin dhe vetëm në seancën e dytë stërvitore ka shënuar edhe një gol. Në një pron-

Sadiku: E çoj Luganon në Europa League

oncim për "RSI" në Zvicër, tregon për këto momente të para pas rikthimit. "Këtu i njoh të gjithë çunat dhe është një atmosferë shumë e bukur. Nuk jam ende në 100% tim, por kemi edhe 2 javë deri në ndeshjen e parë me Tunin. Është e rëndësishme të stërvitemi mirë dhe të jemi gati për takimin.

Të gjithë ata që më njohin, e dinë se sa ambicioz jam dhe se jam më të mirën në fushë. Dua të rikthehem në nivelet më të larta. Dy vite më parë isha këtu tek Lugano dhe bëmë histori duke u kualifikuar në Europa League. Besoj tek ky objektivi i klubit, sepse jemi edhe në Kupë", deklaroi Sadiku.

ALARM NË KORÇË

Shehi rrezikon 5 titullarë ndaj Partizanit

Skënderbeu i Orges Shehit në rrallë ndeshje të këtij sezoni ka qenë i plotë. Korçarët duket se kanë dëmtime të shumta dhe bëhet fjalë për ata lojtarë që kanë bërë diferencën në pjesën e parë të sezonit të Skënderbeu. Bregu e

Lulaj me dëmtime, po ashtu edhe Blerim Krasniqi në dyshim. Madje, edhe po u rikuperua mund ta nisë nga stoli. Por nuk mbetet me kaq, sepse korçarëve në një ndeshje mjaft të rëndësishme, nuk do të kenë gati edhe Fidan Alitin në mbrojtje që ka plotësuar

kartonët e verdhë e po ashtu edhe Demte që ende nuk është gati. Gjithsesi, trajneri Shehi shpreson të ndonjë mrekulli deri ditën e premte...! Me sa duket, trajneri korçar duket se tashmë ka si "rival" edhe dëmtimet dhe pezullimet në skuadrën e tij...!

Luftëtari mposht 3-0 Egnatian. Teuta "OK" në Lushnjë, ndërsa Bylisi fiton 2-0 ndaj Laçit



Jeton Selimi

Apolonia befason Kukësin, Vllaznia thyen Kamzën

Shiu ndërpreu Tirana-Flamurtari, rikuperohet sot në 13:00

Tirana-Flamurtari do të luhet sot në orën 13:00 dhe do të nisë nga minuta e 25-të dhe me rezultatin 0-0, kjo pasi fusha e "Selman Stërmasit" ishte shndërruar në një pellg të madh uji, që ua vështirësoi së tepërmi lojën të dyja skuadrave dhe e detyroi kryesorin Bajramaj fillimisht ta pezullojë takimin dhe më pas, pas një konsultimi me delegatin Nurishmi dhe përfaqësuesit e të dy klubeve, u ra dakord që ndeshja më e rëndësishme e këtij turi të Kupës së Shqipërisë, të rifillojë të nesërmen, pra sot në orën 13:00. Sa për kronikë, sfida deri në minutën e 25-të ishte e mbërthyer në shifrat 0-0, ndërsa Tirana shpërdoroi një 11-metërs në minutën e 11-të, kur Koliçi bën mrekullinë në ekzekutimin e Edon Hasanit. Vllaznia ka arritur të fitojë një takim mjaft të rëndësishëm përballë Kamzës, e vlefshme për Kupën e Shqipërisë. Djemtë e Likës kanë përmbytur skuadrën e Ernest Gjakës, e cila shënoi e para. Ishte Mehmeti, ai që shtangu shkodranët pas një



aksioni të bukur në minutën e 19-të. Megjithatë, në pjesën e dytë Vllaznia reagoi dhe

përmbysi gjithçka, fillimisht me A.Markun dhe më pas me Zhunior, ky i fundit ka

pasur shumë raste në këtë takim dhe ka qenë rrezik konstant për skuadrën e Ka-

KUPA E SHQIPËRISË	
TE MARTEN	
GRUPI A	
Dje	
Kastrioti - Partizani	2-4
Besëlidhja - Skënderbeu	1-2
Sot	
Egnatia - Luftëtari	0-3
Vllaznia - Kamza	2-1
GRUPI B	
Sot	
Apolonia - Kukësi	2-1
Bylis - Laçi	2-0
Lushnja - Teuta	1-3
Sot	
Tirana - Flamurtari	13:00

u shënu në "Loni Papuçiu" të Fierit, aty ku Apolonia vendase fitoi 2-1 me Kukësin, me gola të Gjatës dhe Hysenshahajt, ndërsa finalizimi i vetëm i verilindorëve mban firmën e Et'hemit. Teuta hipetëko kualifikimin me një fitore të thellë 1-3 në fushën e Lushnjës. Për durrsakët shënuan Kallaku, Vila dhe Prongi, ndërsa Gjyla shkurtoi diferencën në 1-3 në fundin e sfidës. Gjithashtu, surpriza ka ardhur dhe nga Bylisi, që mundi Laçin në shtëpi, pastër me rezultatin 2-0. Ndërsa Teuta ka mbyllur gjithçka kundër Lushnjës, pasi fitoi 1-3. Luftëtari ka marruar problemet financiare që ka pasur për 90 minuta, duke dhënë maksimumin kundër Egnatias dhe mori një fitore të sigurt për ndeshjen e kthimit.

mzës. Takimi i ardhshëm do të luhet në Kamëz pas 2 javësh. Një rezultat i papritur

Drejtesi vlonjat ankohet për shpenzime

Behari: Na shkoi një ndeshje kupe 10 milionë lekë

Në kampin e Flamurtarit duket se të gjithë ishin të mëmëdit për ta shtyrë ndeshjen me Tiranën. Por, gazetari Glendi Tafaj i "Super-sport", zbulon një prapaskenë të zyrtarit të klubit vlonjat, Ardi Behari. Trajneri Daja, 1 minutë para se arbitri të merrte vendimin për ta shtyrë ndeshjen, i kishte kërkuar anësorit që të shtyhej, pasi kështu nuk mund të vazhdohej. Ndërkohë, në hollin e stadiumit, zyrtarit i Flamurtarit, Ardi Behari, në një bashkëbisedim me delegatin, ai mësohet të jetë shprehur: "Çfarë do bëjmë, se na shkoi grumbullimi 10 milionë lekë?" Kujtojmë se Flamurtari është i grumbulluar pak kilometra më tej, në Fushë-Krujë, e kështu do i duhet të qëndrojë edhe një natë më shumë në hotel.



Të kuqtë nënshkruajnë me mesfushorin

Zyrtare, Partizani prezanton Dilaver Dukën

Klubi i kuq ka bërë dje prezantimin e mesfushorit Dilaver Duka, i cili ishte bashkuar me Partizanin gjatë fazës përgatitore në Turqi. Akordi me këtë futbollist ishte arritur më parë dhe sot ai ka bërë prezantimin në ambientin e klubit të kuq, në praninë e drejtorit të përgjithshëm Olsi Rama. Duka ka nënshkruar deri në fund të këtij sezonin me Partizanin, me opsionin për të rinovuar edhe për një sezon tjetër. Ja dhe njoftimi i Partizanit. "Klubi njofton arrijten e marrëveshjes me Dilaver Dilly Dukën. Kontrata e firmosur me drejtuesit e klubit do të jetë e vlefshme për pjesën e mbetur të këtij sezoni futbollistik, me opsion rinovimi edhe për vitin e ardhshëm. Mesfushori shqiptar gëzon një karrierë të suksesshme në kampionatin profesionist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku ka qenë pjesë e ekipeve elitare Nju Jork Red Bulls dhe Çikago Fajër. Duka do të provojë eksperiencën e parë në kampionatin tonë dhe do të mbajë në fanellë numrin 28".


Katalanasit befasonjë rivalët

75 milionë për talentin, Barcelona zyrtarizon De Jongun

Barcelona dhe Ajaksi kanë arritur marrëveshjen për transferimin e mesfushorit Frenki de Jong te katalanasit. Futbollisti holandez do të bashkohet me gjigantët spanjollë prej 1 korrikut të këtij viti. Plot 75 milionë euro i ka kushtuar Barcelonës ky operacion, plus 11 milionë bonuse. Lojtari i kërkuar nga klubet më të mëdha në Europë do të nënshkruajë një kontratë pesëvjeçare me katalanasit. Presidenti Bartomeu dhe administratori i Ajaksi, Oskar Grau, kanë mbyllur gjithçka. Frenki de Jong është një nga talentet më premtues të futbollit holandez dhe atij evropian. Ai vjen te Barcelona në moshën 21-vjeçare dhe pritet që të rritet edhe më shumë me fanellën e ekipit të madh spanjoll. De Jong ka qenë një titullar i padiskutueshëm tek Ajaksi dhe një nga lojtarët më të rëndësishëm në ekip. Mund të luajë edhe si mbrojtës dhe Barcelonës i bën shumë punë për të ardhmen.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. E famshmjia Curie
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Kurosawa-s.
11. Eshhtë edhe ai i mendimeve.
12. Një mund të jetë zemërkau
13. Eshhtë dollapi.
14. Gjysmë mimizeo.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Ndodh në kufij.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. Eshhtë dhomë e lartë.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.

34. Janë gjuhë...veshi.
35. Musketierët e Dumas.
36. Lila këngëtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Ullmann aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kapjen.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Eshhtë numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

1. Farrow aktore.
2. Me Romeo në makinë.
3. Rolet pa zë.
4. Kufij itinerari.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Në mes të dhomës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin fushat.
10. Janë festime
11. Lehar kompozitor.
12. Janë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhet fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçiot.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edwards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Lama i Tibeit.
5. Janë vendet e lira
11. Martin i Jack London.
13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
15. Ekstremit në sirtar.
16. Janë princër arabë.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstremit në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Ndaj në kufij
29. Kaluar në krye.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Griet aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshhtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.


40. Janë galeri në rrugë.
41. Ramszotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Eshhtë pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë kandil
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot nga Tantai.
51. Janë thënie e njerëzve të famshëm.
52. Qendër fitimi

VERTIKAL


1. Eshhtë halli.
2. Fillon me rruga...
3. Kastile janë në fund
4. Janë në skaje
6. Eshhtë vendi aderues
7. Ka kryeqytet Doha.
8. Inicialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Igli te Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Flanders e Defoe.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstremit në slam.
22. Janë trille.
25. Qyteti italian.
26. Japon për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshhtë llogarin që qërohet.
36. Ndiden me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Eshhtë melodramë.
40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktor.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në krye të njerëzve.
48. Sikur janë në krye.
49. Inicialet e Taylor që qe aktore..



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	E	A	R	I	S		
A	L	N	E	N	E	N	A	P	T	O	P	
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
I	A	S	M	O	D	E	M	I	R			
S	A	M	T	A	R	A	F	E				
M	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T		
H	A	B	E	R	I	O	M	A	R	A		
T	R	I	T	S	E	R	I	T	E			
T	E	M	E	B	E	L	E					
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	
I	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U	
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S			
R	A	A	F	J	O	E	A	B	E	L	A	
I	T	A	A	A	N	N	A	K	I			
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	I	M	E	D			
E	L	B	A	R	I	O	N	T	O	R		
T	O	K	A	A	L	N	L	E	R	A		
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

			2		4			
		6		4	5			8
		8						
				6				
3	1	5					9	
	7	8					1	5
1				9	8			
		4	2					1
7	6		3	1				2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	6	8	4	7	2	5	9	1
4	7	1	5	9	3	8	6	2
9	5	2	6	8	1	3	4	7
1	3	6	9	4	7	2	5	8
5	4	7	2	6	8	9	1	3
8	2	9	3	1	5	4	7	6
2	8	4	7	5	6	1	3	9
6	9	3	1	2	4	7	8	5
7	1	5	8	3	9	6	2	4

Argëtim filozofik

-Mos iu drejto me ton të ashpër ndokujt . Atyre që do ju drejtohesh kështu mund të të përgjigjen në të njëjten mënyrë : plagët janë të dhimbshme ; njëra pas tjetrës do bien mbi ty .

-Duke mbrojtur veten ke mbrojtur tjerët ; duke mbrojtur tjerët ke mbrojtur veten .

-Fjalët kanë fuqinë e të shkatruarit dhe të krijimit ; kur fjalët janë të singerta dhe të këndshme mund të ndryshojnë botën .

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	6		8	3	6	10		10	4	16	3	2	
10	3	9	5	7	4		8			6	12	4	
4	4		19	4	11	1	2	3	18	5	2		
18		11	5	6	5	13	5	9	4	7	3	2	
5	12	3	2	5	6	3	2		9	5		5	
		6	4	2	4		17	4	1	5			
5	2	3		3	7	2	5		4	6	1		
13	3	12	3	2	3		4	2	5	13	5		
2	13	16			2	5	E		5	12		5	
17	12	4	1	12		7	M	6		2		13	
5	4		7	4	8	4	I	1	12	5	6	4	2
9	13	8		2	17	6	R	4	8	2	3	2	

T	E	K		B	O	M		B	R	E	D	H
O	R	A	T	O	R	E	T		E	S	E	
G	N	O	T	A	R	E	T		T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
R	S	L	R	E	T	E		E	R	I	K	
P	E	L	O	T	A	D	V		M	A		
S	O	T	R	T	A	R	E		E	T		
T	R		G	P	A	R	E		T	E		
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A			
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A		
A	D	I	T	E	T							
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E	

Thënie të mënçura

- Asgjë e gjallë s'duhet vrarë , as insekti apo katsha më e vogël , sepse çdo jetë është e shenjtë .
- Jemi ajo që mendojmë .
- Sa më pak të keni , aq më pak duhet të shqetësoheni .
- Aroma e luleve nuk shkon kundër erës , as i Jaseminut , aroma e të mirëve shkon kundër erës : një njeri i drejtë njihet anë e mbanë

- 8-Eshhtë e nevojshme që njeriu t'i afrohet gjithmonë e më shumë të mirës e të
- përpigjet të ruajë mendjen e tij nga ligësitë .
- Mendja e atij që bën vepra të mira me
- gjysmë zemre , në fakt , merr kënaqësi në të keqe .

